

DEPUTETËT, KUVENDI DHE AKTIVITETI PARLAMENTAR NË SHQIPËRI

MONITORIM DHE ANALIZË
Shtator – Dhjetor 2021



TIRANË 2022

Në funksion të projektit është realizuar aplikacioni online www.deputetim.al ku reflektohen të dhënat e vazhdueshme të monitorimit. Ky është raporti i parë i monitorimit në kuadër të projektit.



EKIPI REALIZUES

Drejtues i projektit

Afrim Krasniqi

Monitorues dhe raportues

Doralda Tanellari

Rudina Niklekaj

Brunilda Duriçi

Juljana Bilbilaj

Eno Muja

Ekspertë kërkimorë

Dorjana Pano

Dorina Berdufi

Kopertina dhe dizajni

M&P Studio

ISBN 978-9928-4694-3-4

Projekt i mbështetur nga Agjencia
Zvicerane per Zhvillim dhe Bashkëpunim



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**

Mendimet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e ISP dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pozicionin zyrtar të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim.

1. **HYRJE**
2. **GJETJET KRYESORE**
 - 2.1 REKOMANDIMET KRYESORE
3. **KUVENDI, PËRFAQËSIMI DHE PROBLEMATIKA**
 - 3.1. PRODUKTI I VOTËS PARAPËLQYESE: 3 NGA 140 DEPUTETË
 - 3.2. PARLAMENTI I RI: DOMINUES EKONOMISTËT DHE BANORËT E TIRANËS
 - 3.3. DORËHEQJET DHE PRAKTIKAT ZËVENDËSUESE PËRPARA LEGJISLATURËS
 - 3.4. TRE MANDATET E DYFISHTA PARLAMENTARE
 - 3.5. KUVENDI I RI: 7 DEPUTETË “DHURATË” PËR GRUPE FIKTIVE PARLAMENTARE
 - 3.6. PARTI FIKTIVE PARLAMENTARE?
 - 3.7. ISH - OPOZITA? 3 PREJ TYRE U RIZGJODHËN NË PARLAMENT
 - 3.8. LEGJISLATURA E RE – DREJTIM I RI PARLAMENTAR?
 - 3.9. ZHVILLIMET NË OPOZITË DHE NDIKIMET NË JETËN PARLAMENTARE
 - 3.10. NJË MODEL PARLAMENTAR PËR DIALOG E BASHKËPUNIM?
4. **KUVENDI, TRANSPARENCA DHE PROBLEMATIKA**
 - 4.1. RISI DHE ELEMENTË POZITIVË NË ASPEKTIN E TRANSPARENCËS
 - 4.2. PROBLEMATIKA ME STANDARDET E TRANSPARENCËS
 - 4.3. DEBAT GJATË GJITHË NATËS PËR QEVERINË?
 - 4.4. KUVENDI, ASNJË DEKLARIM NË REGJISTRIN E KONFLIKTIT TË INTERESIT
 - 4.5. INTERPELANCAT DHE PROBLEMATIKA E TYRE
 - 4.6. KËRKESA PËR INFORMACION: VETËM 10 NGA 140 DEPUTETË
 - 4.7. BERISHA, *DE FACTO* NUK USHTROI FUNKSIONIN E DEPUTETIT
 - 4.8. NISMAT PARLAMENTARE: 3 NISMA DHE DISA PROBLEMATIKA
 - 4.9. PS DHE PD, NISMA PËR NDRYSHIMIN E KUSHTETUTËS
 - 4.10. NISMAT PËR KOMISIONE HETIMORE
 - 4.11. DISA PROBLEMATIKA LIDHUR ME FUNKSIONIN ZGJEDHOR TË KUVENDIT
 - 4.12. VOTIMI I AKTEVE: 58 DEPUTETË 100%, KRYETARËT NË KUOTA KRITIKE
5. **KOMISIONET PARLAMENTARE: BILANCI DHE PROBLEMATIKA**
 - 5.1. PROBLEMATIKA TË PJESËMARRJES NË KOMISIONET PARLAMENTARE
6. **KLASIFIKIMI I EFIKASITETIT TË DEPUTETËVE (SHTATOR – DHJETOR 2021)**
 - 6.1. KLASIFIKIMI I DEPUTETËVE SIPAS NIVELIT TË EFIKASITETIT
 - 6.2. DEPUTETËT MË EFIKASË: TABAKU (PD) DHE BRAÇE (PS)
 - 6.3. DEPUTETËT MË PAK EFIKASË 2021
 - 6.4. VLERËSIMI? OPOZITA MË EFIKASE SESA MAZHORANCA?
 - 6.5. QARKU I SHKODRËS ME DEPUTETËT MË PAK EFEKTIVË
 - 6.6. DEPUTETËT ME MË SHUMË FJALIME?
 - 6.7. FJALIMET NË EMËR TË GRUPIT, DEPUTETËT MË TË PROMOVUAR
 - 6.8. 18 DEPUTETËT ME “0” FJALIME NË PARLAMENT
 - 6.9. RAMA E BASHA: 11,5 ORË DISKUTIME E REPLIKA NË PARLAMENT
7. **RAPORT PARAPRAK I MONITORIMIT TË MARRËDHËNIES SË INSTITUCIONEVE KRYESORE KUSHTETUESE DHE TË PAVARURA ME KUVENDIN**
8. **ANEKS ME TË DHËNA TË DETAJUARA**
 - KLASIFIKIMI SIPAS TREGUESVE TË EFIKASITETIT
 - KLASIFIKIMI I DEPUTETËVE SIPAS NUMRIT TË FJALIMEVE

1. HYRJE

Instituti i Studimeve Politike (ISP) me mbështetjen e Ambasadës së Zvicrës në Tiranë po monitoron Kuvendin dhe aktivitetin parlamentar në Shqipëri. Qëllimi i monitorimit është njohja, evidentimi dhe promovimi i bilancit parlamentar, rolit të parlamentit, standardeve të transparencës dhe të llogaridhënies, të përfaqësimit dhe të funksionit kushtetues të institucionit të Kuvendit.

Projekti monitorues është vazhdim i monitorimit të mëparshëm të kryer nga ISP nga viti 2016, fillimisht me mbështetjen e FES (2016-2017) dhe më pas me mbështetjen e ambasadës së Holandës në Shqipëri (2017-2020). Ambasada e Zvicrës ka qenë dhe mbetet aktive në promovimin e rolit aktiv të shoqërisë civile në monitorimin e proceseve demokratike, vendimmarrëse dhe përfaqësuese në Shqipëri. Qeveria zvicerane ka një program të gjerë asistence dhe mbështetje të kapaciteteve të Kuvendit, projekt që po zbatohet nga bashkëpunimi midis OSBE dhe NDI. ISP është mbështetur në disa nisma nga programe të financuara nga qeveria zvicerane, kryesisht në monitorimin e qeverisjes vendore dhe përfaqësimit politik në këshillat bashkiakë të qarkut Tiranë.

Projekti aktual shtrihet deri në vitin 2023 dhe në funksion të tij është edhe platforma online www.deputetim.al ku janë të pasqyruara raportet tona të monitorimit, aktiviteti parlamentar, të dhënat për deputetët, treguesit e efikasitetit të tyre, fjalimet e mbajtura dhe të dhëna të tjera specifike. Database është në plotësim të vazhdueshëm me të dhëna të reja që dalin nga monitorimi.

Një prej risive të monitorimit të kryer nga ISP është përpjekja për të evidentuar nivelin e efektivitetit të deputetëve mbi bazë të kontributeve personale, mbi bazën e grupeve politike, mbi bazën e gjinisë dhe mbi bazën e përfaqësimit elektoral dhe përvojës parlamentare. Praktika e ndjekur prej vitesh njihet nga deputetët dhe bazohet në kriteret thelbësore të përgjegjësive të deputetëve: nismat ligjore, propozimet në formë të amendamenteve dhe nismave politike, pjesëmarrja dhe diskutimet në komisione dhe në seancat plenare, pjesëmarrja dhe votimi i akteve në parlament, ushtrimi i të drejtës për interpelanca dhe seanca pyetje, si dhe për pyetje të adresuara ndaj institucioneve, si dhe monitorimi i aktivitetit parlamentar bazuar në daljet në media të deputetëve dhe aktivitetit të tyre mediatik (publik). Deputetët marrin vlerësime negative në rastet e penalizimit disiplinor nga Kuvendi. Risi tjetër e këtij raporti është vlerësimi paraprak i monitorimit të funksionit kontrollues të Kuvendit në raport me institucionet e pavarura dhe ato të krijuara me ligj, si dhe reflektimi analitik i përbërjes parlamentare pas zgjedhjeve të 25 prillit.

Përveç procesit monitorues ISP i është përgjigjur pozitivisht të gjitha ftesave të ardhura nga Kuvendi për konsultime publike apo pjesëmarrje në seanca dëgjimore, përfshirë nismat për ndryshime kushtetuese, si dhe ka organizuar disa aktivitete (trajnime dhe konferenca) me pjesëmarrjen e deputetëve nga grupe të ndryshme parlamentare. ISP falënderon kryetaren e Kuvendit, drejtuesit e grupeve parlamentare dhe drejtuesit e administratës në Kuvend për bashkëpunimin korrekt dhe mbështetjen e aktivitetit tonë monitorues.

ISP do të vijojë monitorimin e Kuvendit dhe raportimin publik deri në sesionin e parë të vitit 2023. Raporti i dytë do të jetë publik në fillim të gushtit 2022, si pasqyrim i punës së Kuvendit në sesionin e ardhshëm, janar-korrik 2022.



2.GJETJET KRYESORE TË RAPORTIT

- ❖ Legjislatura e re parlamentare shënoi kthimin në normalitet të institucionit me pjesëmarrjen e të gjitha partive dhe grupeve në punimet e parlamentit. Ndikimet e disa zhvillimeve të brendshme në PD dhe votat në bllok të mazhorancës për çdo akt në shqyrtim, e dobësuan funksionalitetin dhe pluralitetin e Kuvendit, gjithsesi, legjislatura aktuale shfaqet më cilësore sesa në vitet 2019-2021.
- ❖ Kuvendi, ndonëse shënoi disa elementë pozitivë progresi, ende nuk ka arritur të forcojë rolin kushtetues të kontrollit mbi pushtetin ekzekutiv, dhe ekziston perceptimi i gjerë se qeveria vijon të ketë ndikim dhe kontroll si në axhendën parlamentare ashtu edhe në vendimmarrjet e tij. Kryeministri votoi vetëm 59% të akteve të propozuara nga qeveria e tij në Kuvend.
- ❖ Legjislatura e re solli ndryshime thelbësore në përbërjen e trupës drejtuese të Kuvendit (kryesi, komisione, sekretariate), harmoni më të madhe në përfaqësim midis deputetëve me eksperiencë dhe prurjeve të reja, si dhe një qasje më konsensuale të votimit të akteve të rëndësishme parlamentare (42% të akteve).
- ❖ Qeveria vijon të ketë monopolin e nismave ligjvënëse (94%), 2 nisma për ndryshimin e Kushtetutës vijnë në procedurë, ndërkohë që së paku 3 nisma serioze ligjore u iniciuan nga deputetët. Parlamenti i dha mbështetje nismës së opozitës për ngritjen e dy komisioneve hetimore, por refuzoi një nismë të tretë, ndërkohë që secili prej komisioneve nuk ka arritur ende të ketë produkt ligjor dhe institucional, për shkak të përpjekjeve destruktive të palëve brenda komisionit, si për të avancuar akuzat ashtu edhe për të penguar kryerjen e procesit hetimor.
- ❖ Deputetët realizuan 3 interpelanca dhe 1 seancë pyetjesh, më shumë se 35 deputetë morën pjesë në debatet e dedikuara problematikave të zgjedhësve dhe më shumë se dy të tretat e deputetëve ishin pjesëmarrës në debatet aktive në komisione dhe në seanca plenare. Institucioni i interpelancës, i seancës së posaçme


për pyetje dhe për zgjedhësit, etj, vijnë të jenë të brishtë duke u dominuar nga retorika politike ditore.

- ❖ Deputetët me nivelin më të lartë të efikasitetit në sesionin parlamentar ishin Jorida Tabaku (PD) dhe Erion Braçe (PS), ndërkohë që 18 deputetë nuk ishin aktiv në komisione dhe as në seanca plenare, duke mos lënë gjurmë të aktivitetit të tyre parlamentar. Në nivel grupesh, deputetët e PD patën koeficientin më të lartë të efikasitetit (36%), ndjekur nga deputetët e LSI (34%) dhe më pas ata të PS (33%). Deputetët e PSD ishin grupi partiak me rekorde më minimale, duke mos pasur asnjë diskutim në komisione dhe as në seanca plenare, si dhe duke mos përdorur asnjë prej mekanizmave ligjvënës e përfaqësues që ofron Kuvendi.
- ❖ Gratë deputete ishin shumë më aktive, sesa deputetët meshkuj (+3% në nivel krahasues në parlament), ato patën statistikisht 4 diskutime për deputete ndaj 3 diskutimeve për deputetët meshkuj. Nga ana tjetër, deputetët e vjetër ishin +7% më aktivë sesa deputetët e rinj, prurje nga zgjedhjet parlamentare të vitit 2021. Opozita dominoi me 52% të diskutimeve, por në kohë diskutimi mazhoranca ishte dominuese.
- ❖ Ligjërimi politik parlamentar vijon të jetë i ngarkuar dhe i personalizuar, në disa raste edhe denigruet mbi bazë gjinore, moshore dhe politike, duke mbetur një pengesë serioze në qëllimin e Kuvendit për rritjen e besimit publik, të integritetit dhe të llogaridhënies.
- ❖ Praktikimi i mbledhjeve të komisioneve online, ndonëse është i kushtëzuar dhe tenton të ofrojë akses më të madh publik, vijon të shfaqë vështirësi në jetësimin e transparencës dhe aksesit për median e publikun. Vonesa në publikimin e procesverbaleve dhe mangësitë në procesin e konsultimeve publike mbeten një shqetësim i vazhdueshëm.
- ❖ Kuvendi ka shënuar progres në drejtim të rritjes së disa elementëve të transparencës, sidomos në aspektin statistikor. Një database e ofruar online nga Kuvendi me bilancin e akteve, votimeve, kohës së debatit, angazhimeve gjinore dhe politike, mbi natyrën e akteve dhe vendimmarrjet, etj, përbën një zhvillim pozitiv dhe plotëson një prej mangësive të legjislativave të kaluara. Gjithashtu disa broshura dhe manuale informative mbi Kuvendin, rolin dhe aktivitetin e tij përbëjnë gjithashtu risi dhe kontribut pozitiv në drejtim të konceptit “parlament i hapur”.

2.1. REKOMANDIMET KRYESORE

- ❖ Kuvendi duhet të investojë më shumë në rritjen e klimës së besimit politik midis mazhorancës dhe opozitës për prioritetet politike e legjislativave të vendit, siç janë reforma zgjedhore, ndryshimet kushtetuese, zgjedhja e Presidentit të Republikës, reforma në drejtësi dhe kriteret e procesit të integritetit.

- ❖ Kuvendi ka nevojë të trajtojë me prioritet ndryshime përmirësuese në Rregulloren e Kuvendit dhe në ligjin për statutin e deputetit, si dhe në aktet plotësuese rregullatore, në mënyrë që normat organizative dhe rregullimi i jetës parlamentare të përputhet me sfidat e sotme të parlamentit të një vendi kandidat për në BE, për më shumë transparencë, konsultim dhe llogaridhënie.
- ❖ Kuvendi duhet të forcojë komponentin e kontrollit kushtetues mbi pushtetin ekzekutiv dhe institucionet e varësisë dhe ato të pavarura. Platforma institucionale duhet të jetë më e gjerë, më transparente dhe më aktive, në përputhje me rezolutat, por edhe sfidat e reja të institucioneve dhe të vendit.
- ❖ Partitë politike dhe grupet parlamentare duhet të evitojnë sa të jetë e mundur transferimin e konflikteve të tyre të brendshme në axhendën parlamentare, si dhe të përmirësojnë aktet e tyre të brendshme rregullatore, duke nxitur standarde më të larta etike, konkurrencë dhe cilësi në përfaqësimin parlamentar të deputetëve të tyre.
- ❖ Kuvendi mund të aplikojë standarde më të larta transparence dhe konkurrence në shpalljen e vendeve vakante dhe në procesin e zgjedhjeve në institucione, duke aplikuar seanca dëgjimore, duke ofruar informacion cilësor mbi kandidatët, duke respektuar afatet ligjore dhe duke evituar rastet e vendeve vakante.
- ❖ Komisionet e përhershme në Kuvend do të duhet të publikojnë raportet vjetore të aktivitetit të tyre, të cilat të jenë të disponueshme edhe për publikun, si dhe të kenë në themelin e tyre bilancin real të punës, problematikave, sfidave dhe përgjegjësi. Forcimi i komisioneve është në interes të Kuvendit dhe procesit legjislativ, transparenca dhe llogaridhënia e tyre është në interes të publikut, procesit ligjvënës dhe besimit publik tek parlamenti.
- ❖ Kuvendi ka nevojë urgjente për një rikompozim dhe riorganizim të faqes online, duke krijuar një faqe më aktive, më të referueshme, më të plotë dhe më të ngjashme me modelet e mira të parlamenteve të vendeve anëtare në Bashkimin Europian.
- ❖ Në seancat plenare dhe për rrjedhojë edhe në publikimin e procesverbaleve drejtuesi i seancës, në momentin që deklaron votimin, duhet të deklarojë me zë edhe rezultatin shifror të votimit, në mënyrë që rezultati të reflektohet në procesverbal dhe kështu, të plotësojë standardet e dokumentacionit zyrtar.
- ❖ Kuvendi duhet të dëshmojë vëmendje më të madhe ndaj standardeve të Kodit të Etikës, përfshirë hetimin e rasteve të mundshme të konfliktit të interesit, marrjen e masave administrative në rastin e shkeljeve të etikës dhe gjuhës denigruese, jetësimin e regjistrave të deklarimit dhe hetimin e thelluar të çdo rasti të raportimit publik mbi shkelje të mundshme nga Kuvendi apo deputetët në aktivitetin e tyre parlamentar.



3. KUVENDI, PËRFAQËSIMI DHE PROBLEMATIKA

Legjislatura e re (2021-2025) doli nga zgjedhjet parlamentare të 25 prillit 2021. Këto ishin zgjedhjet e dhjeta në historinë post - komuniste në Shqipëri dhe rasti i parë kur mazhoranca në qeveri siguroi një mandat të tretë radhazi dhe zgjedhjet e shtata, në të cilat një parti e vetme fiton shumicën e mandateve në parlament (1991, 1992, 1996, 1997, 2001, 2017, 2021). Zgjedhjet 2021 ishin zgjedhjet e para pas bojkotit kolektiv të opozitës në parlament (2019-2021) shoqëruar me dorëzimin e mandateve parlamentare dhe bojkotit të zgjedhjeve lokale (2019).

3.1. PRODUKTI I VOTËS PARAPËLQYESE: 3 NGA 140 DEPUTETË

Në zgjedhjet parlamentare 2021 u aplikua për herë të parë vota e parapëlqyer, sipas të cilës, në një listë të hapur kandidati me më shumë se 10 mijë vota mund të siguronte mandat parlamentar duke zhvendosur kandidatin e të njëjtës gjini me numër më të vogël votash në krye të listës proporcionale të të njëjtit subjekt politik.

Formula e re pritej të krijonte konkurrencë më të madhe elektorale, megjithatë referuar të dhënave zyrtare të KQZ, vetëm 3 kandidatë arritën të kapërcejnë renditjen partiake dhe të kalojnë nga zona humbëse në zonën fituese.

- Dy nga kandidatët fitues i përkasin subjektit politik, Partia Socialiste, në qarkun Tiranë. Ish-ministri Fatmir Xhafaj, i renditur në vendin nr.23 në listën shumëemërore fitoi 16,738 vota, duke fituar mandatin e numrit 15 të listës, Fidel Ylli, i cili mori 1726 vota.

- Kandidati i ri, Orlando Rakipi, djali i ish-deputetit të PDIU, Aqif Rakipi, i cili humbi mandatin në legjislaturën e kaluar për shkak të dekriminalizimit, shënoi rezultatin më befases zgjedhor: ai fitoi 15,697 vota në qarkun Tiranë, duke kaluar nga vendi 30 i listës shumëemërore në vendin e tretë, duke i marrë mandatin kryetarit të PS Tiranë Ervin Bushati, i cili fitoi vetëm 2990 vota.
- Në Elbasan, deputeti i PD-së Luçiano Boçi, i renditur jashtë pjesës fituese (vendi nr. 7), arriti të fitojë 10,930 vota, duke u zhvendosur në vendin e pestë, dhe kështu, duke lënë jashtë parlamentit numrin 5 të listës shumëemërore Eugen Isaj, i cili mori 3663 vota.

Duhet thënë se disa nga kandidatët e PS, ndonëse në renditjen fundore brenda listës fituese, morën numër të lartë votash, vota të cilat, në kushtet e aplikimit të votës parapëlqyese, do t'u siguronin atyre mandat fitues.

- Për shembull, Blendi Klosi (Berat) mori 12,399 vota, Taulant Balla (Elbasan) mori 21,604 vota, Saimir Hasalla (Elbasan) mori 11,518 vota, Erion Brace dhe Gramoz Ruci (Fier) morën përkatësisht 15,622 dhe 10,292 vota, Edi Rama (Durrës e Vlorë) mori përkatësisht 15,622 dhe 11,412 vota, Bledar Çuçi (Gjirokastër) mori 11,932 vota, Niko Peleshi (Korçë) mori 11,475 vota, Arben Ahmetaj dhe Belinda Balluku (Tiranë) morën përkatësisht 11,287 dhe 15,361 vota. Disa prej tyre (Klosi, Balla, Ruçi, Rama dhe Peleshi) ishin në vendin fundor fitues të listës, të tjerët në vende të sigurta, pavarësisht numrit të votave.
- Në listën e PD kjo skemë nuk funksionoi, duke pasur vetëm katër kandidatë me më shumë se 10 mijë vota: në Tiranë (Lulzim Basha me 16,195, Agron Shehaj me 13,855 dhe Belind Këlliçi me 11,601 vota) si dhe në Elbasan (Luçiano Boçi me 19,930 vota).

3.2. PARLAMENTI I RI: DOMINUES EKONOMISTËT DHE BANORËT E TIRANËS

Një pjesë e deputetëve kanë deklaruar të dhëna të plota për profesionet, një pjesë të dhëna të pjesshme dhe një pjesë më e vogël të dhëna formale pa një objektiv të saktë. Megjithatë, stafi monitorues mbledhi të dhëna nga burime të tjera paralele, përfshirë partitë politike dhe deklaratat e dekriminalizimit/kandidimit, për të plotësuar të dhënat e profesioneve të deputetëve.

Sipas të dhënave përmbledhëse kategoria më e madhe e deputetëve i përket profesioneve ekonomike (37), ndjekur nga formimi juridik parësor ose dytësor (30), studimet inxhinierike (13), për gjuhë të huaja (7), për administrim biznes (5) në shkollë ushtarake apo policore (4), nga 3 deputetë në agronomi, shkenca politike dhe kimi, etj. Dy deputetë janë diplomuar në arte, një prej të cilëve është kryeministri. Krahasuar me legjislaturën e kaluar është rritur numri i deputetëve me njohuri ekonomike dhe ka rënë numri i deputetëve me formim juridik.

Lidhur me zonat e banimit, në total, 61% e deputetëve të parlamentit të ri janë banorë të Tiranës, vetëm 39% banojnë në zonat zgjedhore jashtë kryeqytetit, kryesisht në zonat afër Tiranës (Durrës, Elbasan, etj).

3.3. DORËHEQJET DHE PRAKTIKAT ZËVENDËSUERE PËRPARA LEGJISLATURËS

Një nga dukuritë e veçanta të kësaj legjislature ishin dorëheqjet e disa deputetëve të zgjedhur përpara fillimit të legjislaturës.

- *Fillimisht, kryetari i PSD Tom Doshi, pjesë e listës së zezë amerikane, dha dorëheqjen nga mandati parlamentar një ditë pas zgjedhjeve të 25 prillit. Mandati i tij në Tiranë i kaloi kandidatit pasues në listën shumëemërore, Gertjan Deda, i cili mori vetëm 686 vota, kurse në Shkodër mandati gjithashtu vijoi me emrin në listën pasuese, Meri Markiçi, me 749 vota të fituara në zgjedhje.*
- *Kryetari i Kuvendit të kaluar, Gramoz Ruci, i cili ndonëse ishte në pjesën numerikisht humbëse të listës shumëemërore, për shkak të votës parapëlqyese (10,292) doli në vendin e dytë në qarkun Fier. Vendin e tij, bazuar në parimin e kuotës gjinore, nuk e fitoi kandidati pasues me numrin 11, por kandidatja e renditur një vend më poshtë, Mirela Pitushi, e cila statistikisht rezultoi të kishte numrin më të lartë të votave të kandidatëve jo fitues të listës.*
- *Në Durrës, ish-ministri Lefter Koka, figurë e njohur drejtuese e LSI në dy legjislaturat e fundit, kandidoi dhe fitoi nën siglën e PS, duke marrë 9,609 vota. Ai dha dorëheqje nga mandati, për pasojë, vakanca u plotësua nga kandidati vijues i listës, Denis Deliu. Rasti i Durrësit është specifik, sepse ndryshe nga rastet e tjera, KQZ aplikoi një sistem zëvendësimi të ndryshëm. Përpara daljes së rezultateve finale të zgjedhjeve zëvendësimi vijonte me emrin pasues, duke respektuar kuotat gjinore, por pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, KQZ rirendiste kandidatët sipas votave dhe zëvendësimi bazohej në listën e re. Për shembull, përpara daljes së rezultatit final mandati i z. Koka do t'i kalonte numrit 9 të listës (Ana Dhamo), por pas renditjes finale, mandati i kaloi numrit 13 të listës, Denis Deliu.*
- *Në Tiranë dha dorëheqje numri dy i listës shumëemërore, Najada Çomo, mandati i të cilës i kaloi kandidates së parë grua në listën tek numrit fitues, Mimi Kodheli, e cila ishte në vendin 21 nga 18 mandatet e fituara. Kodheli fitoi 5597 vota, më pak sesa 3 mijë vota të kandidatit tjetër paraardhës në listë, ish-kryeministri Pandeli Majko, por fituesi u vendos mbi bazën e kriterëve gjinore të KZGJ.*
- *Nga grupi parlamentar i PD pati vetëm një dorëheqje, ajo e deputetit Mark Marku, i cili kryesoi listën e Lezhës me 5321 vota. Sipas parimit të respektit të kuotës gjinore, mandati i z.Marku i kaloi zonjës Elda Hoti, e cila fitoi 2733 vota. Zonja Hoti ishte në vendin fundor të listës shumëemërore (vendi nr.9) por kriteri i Kodit Zgjedhor mbi kuotat gjinore e lejoi atë të marrë mandatin parlamentar.*

3.4. TRE MANDATET E DYFISHTA PARLAMENTARE

Kodi Zgjedhor u mundësoi kryetarëve të partive politike të kandidonin njëherësh në katër zona të ndryshme zgjedhore dhe teorikisht, të fitonin njëherësh katër mandate parlamentare, duke pasur të drejtën në fund të zgjedhin vetë se cilin mandat do të pranonin. Kjo praktikë privilegjuese për kryetarët e partive u kritikua edhe në Opinionin e Komisionit të Venecias mbi ndryshimet kushtetuese dhe në Kodin Zgjedhor, gjithsesi u aplikua nga pjesa pjesërisht më e madhe e kryetarëve të partive.

Për shkak të këtij rregulli, tre deputetë fituan mandate njëherësh në dy qarqe: Edi Rama (PS) në Vlorë dhe Durrës, Monika Kryemadhi (LSI) në Fier dhe Tiranë), si dhe Tom Doshi (PSD) në Tiranë e Shkodër.

- Zoti Rama fitoi në Vlorë 11,412 vota, por zgjodhi mandatin e qarkut Durrës, ku kishte 15,871 vota. Vendin e tij e zuri kandidatja pasuese në listën e Vlorës, Teuta Ramaj.
- Në Fier Monika Kryemadhi mori 1771 vota, duke qenë në krye të listës së LSI, dhe zgjodhi të mbajë këtë mandat, ndërkohë që në Tiranë ajo ishte gjithashtu në krye të listës me 2446 vota, por mandati i saj i kaloi kandidatit të gjinisë tjetër në renditjen pasuese shumëemërore, Petrit Vasili, i cili mori vetëm 362 vota, duke lënë jashtë parlamentit numrin 3 të listës Përparim Spahiun, i cili kishte rreth 10 herë më shumë vota.
- Tom Doshi fitoi 2024 vota në Tiranë dhe 7886 vota në Shkodër, duke pasur të drejtë të zgjedhë njërin prej dy mandateve, por ai vendosi të japë dorëheqjen nga mandati dhe për pasojë, mandati i tij në dy qarqet u zëvendësua nga emrat pasues të listës.

3.5. KUVENDI I RI: 7 DEPUTETË “DHURATË” PËR GRUPE FIKTIVE PARLAMENTARE

Bazuar në Rregulloren e Kuvendit deputetët deklarojnë në fillim të legjislaturës përkatësinë e tyre politike, mbi të cilën krijohen edhe grupet parlamentare. Sipas Rregullores një grup parlamentar mund të krijohet nga 7 deputetë. Bazuar në rezultatin final të zgjedhjeve vetëm dy parti kanë më shumë se 7 deputetë, PS dhe PD. Megjithatë, përmes mekanizmit të dhurimit të emrave për partitë më të vogla politike, parlamenti i ri do të ketë së paku katër grupe parlamentare.

Dy grupet e reja quhen grupi parlamentar për “Demokraci dhe Integrim” (D&I) dhe grupi parlamentar “ Aleanca për Ndryshim” (AN).

- Në grupin e parë parlamentar bëjnë pjesë 3 deputetë të PDIU që ishin pjesë e listës shumëemërore të PD (Idrizi, Doda dhe Avdulla), si dhe katër deputetë të dhuruar nga PD (Dhori, Ulliri, Jakupllari dhe Mahmutaj).
- Në grupin AN bëjnë pjesë kryetarët e partive aleate pjesë e listës shumëemërore të PD (Mediu, Duka, Dule dhe Shehi), si dhe tre deputetë të dhuruar nga PD (Bakiu, Hoti dhe Koliqi).

Praktika e grupeve parlamentare fiktive, me deputetë të dhuruar nga partitë e mëdha, është aplikuar në pothuajse të gjitha legjislaturat pas mesit të viteve '90. Deputetët që jepen “dhuratë” për grupe fiktive parlamentare nuk kanë asnjë lidhje tjetër me grupin ku bëjnë pjesë, përveçse delegimin numerik për të arritur kufirin minimal prej 7 deputetësh. Nga ana tjetër, kur partitë e vogla nuk gjejnë aleanca politike mbështetëse, ndonëse me numër më të madh deputetësh, mbeten pa grupe parlamentare. Për shembull, PR me 1 deputet krijon grup me 7 deputetë, kurse LSI ka 4 mandate dhe PSD me 3 mandate nuk përfituan deputetë shtesë nga partitë e mëdha, duke mbetur pa grup parlamentar.

Në tërësi, në listën e deputetëve të dhuruar në shtator 2021 bëjnë pjesë edhe funksionarë të lartë politikë, - një tregues i formalizmit dhe i mungesës së rëndësisë për identitetin politik, për respektin ndaj zgjedhësve dhe respektin ndaj publikut. Ekzistenca e grupeve parlamentare lidhet me privilegje parlamentare në përfaqësim, në vendimmarrje, në trajtim administrativ dhe financiar, si dhe në aksesin më të madh në debatet politike në komisione dhe sidomos në seancat plenare.

3.6. PARTI PARLAMENTARE FIKTIVE?

Bazuar në rezultatin zyrtar të KQZ dhe subjektet elektorale me listë shumëemërore në parlamentin e ri do të duhej të ishin zyrtarisht 4 parti politike (PS, PD, LSI dhe PSD). Pas deklarimit të deputetëve në fillimin e legjislaturës, të dhënat e KQZ dëshmojnë se zyrtarisht ekzistojnë 11 parti parlamentare. Krahas katër partive të mësipërme, figurojnë me përfaqësim edhe PLL, PBDNJ, PR, PAA, PDIU, LZHK, MEGA.

Cilësimi "parti parlamentare" u jep partive politike respektive privilegje që lidhen me përfaqësimin, financimin dhe aksesin e barabartë në vendimmarrje e procese të rëndësishme, ku në disa raste përfshihet edhe vetë parlamenti. Disa prej këtyre partive janë formale dhe fiktive në funksionim, por përfshirja në listat shumëemërore të partive të mëdha u jep atyre mundësinë të cilësohen parlamentare dhe të marrin një status, të cilin *de facto* nuk e kanë dhënë zgjedhësit në 25 prill. Në këtë rast parlamenti nuk është përgjegjës për informalitetin në deklarime dhe përfaqësim, por një rregullim më i qartë ligjor do ta ndihmonte procesin të jetë shumë më transparent dhe më llogaridhënës.

Me zhvillimet e reja brenda opozitës një grup deputetësh do të mbeten pa përfaqësim zyrtar dhe me siguri, nëse konflikti politik i tyre nuk merr zgjidhje, përbërja parlamentare do të pësojë ndryshime në strukturë dhe në organizim. Ndikim pritet të ketë edhe në grupet parlamentare aktuale.

3.7. ISH OPOZITA? 3 PREJ TYRE U RIZGJODHËN NË PARLAMENT

Nga legjislatura e kaluar kandiduan disa prej deputetëve, të cilët patën zëvendësuar deputetët e PD dhe të LSI pas dorëzimit kolektiv të mandateve. Ata u konsideruan zyrtarisht opozitë parlamentare, por në zgjedhjet e vitit 2021 disa prej tyre konkurruan në listën shumëemërore të PS-së. Në total vetëm 3 deputetë "të opozitës parlamentare" u rizgjodhën deputet më 2021, dy në listën e mazhorancës dhe një në listën e opozitës. Konkretisht, Lefter Koka (ish - LSI, fitues në listën e PS Durrës), Aurora Mara (ish - LSI, fituese në listën e PS Dibër), si dhe Elda Hoti (ish - LSI, fituese në listën e PD Lezhë). Tetë kandidatë të tjerë nuk arritën të kenë sukses, megjithëse kandiduan me partitë e mëdha ose me partitë e vogla, përfshirë edhe ata që krijuan parti të reja politike.

3.8. LEGJISLATURA E RE – DREJTIMI RI PARLAMENTAR?

Legjislatura e re solli ndryshim radikal të ekipit drejtues të legjislaturës paraardhëse, pavarësisht se zgjedhjet nuk sollën rotacion politik. Bazuar në të dhënat e KQZ në legjislaturën e re nuk do të jenë kryetari dhe as dy zv/kryetarët e Kuvendit të kaluar, asnjë nga 10 anëtarët e ish - Byrosë së Kuvendit, si dhe mbi 50-60% e drejtuesve në sekretariate dhe komisione. Kryetari dhe zv/kryetarët e rinj të Kuvendit janë gjithashtu për herë të parë në pozita të tilla drejtuese (Nikolla, Felaj dhe Alibeaj). Nga kryetarët e grupeve parlamentare Balla (PS), Mediu (PR), Doda (GDI) kanë përvojë të mëparshme parlamentare, kreu i grupit të PD Rushaj është deputet për herë të parë. Nga kryetarët e Komisioneve në legjislaturën e kaluar janë konfirmuar në detyrë vetëm Kodheli e Voksh. I konfirmuar është edhe Shalsi, i cili për një periudhë të shkurtër ka qenë kryetar komisioni.

Ndryshimet në zgjedhje janë praktikë e përhershme parlamentare, por në disa struktura parlamentare, sidomos ato që kanë të bëjnë me vetë rolin e Kuvendit në sistemin kushtetues, në kriza politike dhe në perceptimin e ndjeshëm publik, nevojitet vazhdimësi më e madhe ekspertize dhe eksperience politike. Të tilla janë pozitat e kryetarëve të komisioneve të përhershme dhe ato të përkohshme, të komisioneve hetimore, etj, por edhe në struktura të rëndësishme, siç janë Këshilli për Legjislacionin.

Për ilustrim, në strukturën më të rëndësishme (Këshilli për Legjislacionin dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut) nga 31 anëtarë, 50% janë deputet për herë të parë (Klevis Xhoxhi, Saimir Hasalla, Denis Deliu, Eduard Ndreca, Alqi Bllako, Gerta Duraku, Toni Gogu, Gledis Çeliku, Etilda Gjonaj, Bardhyl Kollçaku, Lavdrim Krrashi, Gazment Bardhi, Saimir Korreshi, Greta Bardeli, Bledion Nallbati dhe Alfred Rushaj). Komisioni i dytë më i rëndësishëm është Komisioni për Ekonominë dhe Financat, i përbërë nga 20 deputetë, nga të cilët, 50% janë deputetë për herë të parë (Sorina Koti, Pranvera Resulaj, Shpresa Marnoj, Alban Xhelili, Enslëmvera Zake, Arbi Agalliu, Emilja Koliqi, Anila Denaj, Benet Beci dhe Alfred Rushaj).

Këto struktura kanë rëndësi të veçantë në legjislaturën aktuale, jo vetëm për kontrollin kushtetues dhe buxhetin, por edhe pasi prej muajsh ka nisur diskutimet për dy ndryshime në Kushtetutën e RSH, ku kërkohet ekspertizë e lartë, përvojë profesionale dhe aftësi parlamentare në menaxhimin e seancave dëgjimore. Fakti se gjysma e anëtarëve janë deputetë të rinj pa përvojë parlamentare, disa prej të cilëve janë drejtues të rëndësishëm politikë në grupe dhe në komisione, e bën të brishtë standardin për ekspertizë të lartë parlamentare për ndryshimet kushtetuese, në kontrollin kushtetues dhe në çështjet e buxhetit. Kjo dobësi është reflektuar edhe punën e deritanishme të këtyre strukturave, sidomos në debatin kushtetues, ku shumica e deputetëve të rinj, kanë qenë aty vetëm formalisht, pa arritur të japin ndonjë kontribut të spikatur profesional dhe parlamentar.

3.9. ZHVILLIMET NË OPOZITË DHE NDIKIMET NË JETËN PARLAMENTARE

Në raportin “Risitë dhe sfidat kryesore të legjislaturës së re”, të publikuar nga Instituti i Studimeve Politike më 23 gusht 2021 vlerësohej se një nga sfidat kryesore të parlamentit të ri do të jetë mënyra sesi PD do ta zgjidhë çështjen e mandatit të ish-Presidentit dhe ish-Kryeministrit Berisha, të përfshirë në listën e zezë amerikane në maj 2021. Në raport paralajmërohej se *“zoti Berisha ka ndikim direkt në më shumë se 25% të grupit parlamentar të PD, si dhe në përqindje më të lartë tek anëtarësia e saj. PD pritet të marrë një vendim të ndërmjetëm përpara nisjes së legjislaturës së re dhe pas zgjedhjes së kryesisë dhe sekretariatit të ri. Çdo vendimmarrje në këtë çështje do të ketë impakt direkt në cilësinë e jetës parlamentare”*¹.

Paralajmërimi i PD doli i saktë, vendimi i kryetarit të PD për pezullimin e z. Berisha nga grupi parlamentar solli zhvillime intensive dhe të papritura në këtë parti dhe në jetën politike. Prej datës 9 shtator, kur u publikua ky vendim, PD nuk ka vepruar më si opozitë e njësuar parlamentare dhe prioriteti kryesor në aktivitetin e saj ka qenë debati mbi legjitimitetin e ekipit drejtues dhe rivalitetet për drejtimin e ardhshëm.

Zhvillimet në partinë kryesore të opozitës ndikuan në tërësinë e aktivitetit, axhendës dhe bilancit parlamentar. Zhvillimet parlamentare u lanë në hije nga retorika politike në PD. Mungesa e një opozite efektive, të organizuar dhe strategjike në aktivitetin parlamentar e ka dobësuar edhe cilësinë e rolin e parlamentit në ushtrimin e funksioneve kryesore kushtetuese, përfshirë ushtrimi i kontrollit kushtetues, kontrolli i pushtetit ekzekutiv, procesin legjislativ dhe atë përfaqësues. Debati brenda opozitës u shoqërua me ndryshime të shpeshta të ekipeve drejtuese, përfshirë edhe drejtues të komisioneve parlamentare, si dhe nga ana tjetër, me një sjellje arrogante të mazhorancës ndaj kërkesave dhe të drejtave të opozitës.

Disa nisma të opozitës, siç ishin dy komisione hetimore, mbetën në hije gjithashtu nga zhvillimet paralele në PD dhe për shkak të interesave politike në parlament për të mos kryer hetime serioze dhe për pasojë, për të penguar dhe pamundësuar një raport serioz dhe shterues mbi problematikat e ngritura në çështjet hetimore. Në disa raste vetë mazhoranca vendosi bojkotimin e mbledhjeve të komisioneve hetimore, një sjellje unike në praktikën parlamentare, por edhe një tregues se parlamenti ende nuk ka një qasje serioze dhe institucionale ndaj instrumentit [kushtetues të komisioneve hetimore](#).

¹ ISP. Raport mbi risitë, pritshmëritë dhe sfidat e parlamentit të ri, gusht 2021 <http://isp.com.al/index.php/2021/08/25/isp-parlamenti-i-ri-2021-2025-risite-pritshmerite-dhe-sfidat-kryesore/>

3.10. NJË MODEL PARLAMENTAR PËR DIALOG E BASHKËPUNIM?

Tradicionalisht legjislaturat e reja kanë reflektuar qasje të re në raportet politike, kryesisht në rastet kur fjalimet inaugurose (të kryeministrit dhe sidomos të kryetares të Kuvendit) theksojnë gatishmërinë për dialog e sjellje konstruktive ndaj opozitës politike. Tradicionalisht ka pasur e ka diferencë të madhe midis deklarimeve, angazhimeve dhe rezultateve konkrete dhe për pasojë, ka mbetur sfidë ende e papërbushur jetësimi i këtij premtimi. Legjislatura aktuale nuk përbën përjashtim.

Në praktikën e mira parlamentare, kur drejtuesi i grupit kryesor të opozitës kërkon konsultim me grupin, pushim të shkurtër, një ndryshim procedural apo ndikim në rendin e ditës, përfshirje në kalendarin e punimeve të çështjeve specifike me interes emergjent publik apo praninë e kryeministrit gjatë debatit parlamentar, këto kërkesa përgjithësisht i jetësohen.

Në rastin tonë, që në seancën e parë zgjedhore opozita zgjodhi një veprim ekstrem, jo serioz dhe të gabuar për të shprehur kundërshtimin ndaj kandidatës së mazhorancës për kryetare parlamenti, duke grisur fletët e votimit. Nga ana tjetër, Kryetarja e Kuvendit ka premtuar të sigurojë mjedis bashkëpunues me opozitën, megjithatë ende Kuvendi nuk ka ndërmarrë ndonjë akt politik apo institucional në drejtim të rivendosijes së besimit dhe këtij bashkëpunimi. Po ashtu, që në seancat e para, përfshirë ato të krijimit të grupeve parlamentare, të debatit mbi programin dhe buxhetin, dhe deri tek mbledhjet rutinë të komisioneve, disa kërkesa të arsyeshme të partive të opozitës morën përgjigje refuzuese nga mazhoranca, shpesh duke provokuar bojkotimin e mëtejshëm të seancës apo mbledhjes nga opozita.

ISP DHE KUVENDI

Më **17 nëntor 2021** kryetarja e Kuvendit, zonja Lindita Nikolla dhe stafi i saj pritën në takim me kërkesë të tyre, ekipin drejtues të projektit të ISP. Gjatë takimit zonja Nikolla u informua për projektin monitorues të ISP dhe u diskutuan aspekte të ndryshme që kanë të bëjnë me aktivitetin parlamentar, me transparencën dhe me bashkëpunimin me shoqërinë civile. Takimi ishte pozitiv dhe shënoi një raport të ri institucional midis Kuvendit dhe ISP.

Më **11-12 tetor 2021** ISP në bashkëpunim me Qendrën Europiane të Studimeve të Sigurisë (CESS) organizoi trajnimin vijues me institucionet e ndryshme lidhur me mbikëqyrjen parlamentare në sektorin e sigurisë. Në këtë trajnim morën pjesë edhe përfaqësues nga parlamenti.

Më **3-6 nëntor 2021** ISP u ftua nga fondacioni Konrad Adenauer, për të referuar në një sesion trajnues me deputetë të parlamentit lidhur me rolin e deputetëve dhe të parlamentit në procesin e integritetit.

Më **15 dhjetor 2021** ISP dhe ASP organizuan konferencë lidhur me rolin e burimeve shtetërore në fushatë dhe sfidën e dekriminalizimit, ku morën pjesë edhe deputetë e përfaqësues të Kuvendit. Gjatë debatit u diskutua për reformën e ardhshme zgjedhore dhe rekomandimet përkatëse për ndërhyrje.

Më **16 nëntor 2021** ISP me mbështetjen e EU dhe UK organizoi tryezë debati lidhur me reformën zgjedhore, bazuar në gjetjet nga monitorimi i zgjedhjeve 2021 dhe puna kërkimore e dy ekspertëve ndërkombëtarë. Në tryezë morën pjesë përfaqësues nga katër partitë kryesore parlamentare, të cilët diskutuan dhe shprehën vlerësime lidhur me prioritetet e reformës së ardhshme zgjedhore dhe në legjislatonin mbi partitë politike.

Më 23 shtator debatet u përqendruan në ankesat e opozitës lidhur me vendimin e Konferencës së Kryetarëve për zhvillimin online të mbledhjeve të komisioneve të përhershme. Pavarësisht traditës, ku vendimet krijojnë konflikte politike, mbetet rast për reflektim praktika kur Konferenca e Kryetarëve merr vendime me natyrë jo konsensuale, sidomos vendime që lidhen me funksionimin e punës në komisione dhe në seanca plenare. Vendime të tilla do të duhet të jenë konsensuale dhe transparente, në mënyrë që asnjë palë politike të mos ndjehet e diskriminuar.

Praktika, sipas të cilës mazhoranca bojkoton mbledhje të komisioneve të posaçme hetimore, opozita bojkoton mbledhje të debateve mbi ndryshimet kushtetuese, administrata ndjek linjën e mazhorancës në vlerësimet e diskutueshme për legjitimitimin e mbledhjeve dhe transmetimin e tyre online, delegacione parlamentare që vizitojnë vende të tjera përbëhen nga deputetë të vetëm një pale politike, apo kur ka pretendime se zyrtarë të lartë, përfshirë ministra dhe zv/ministra nuk i përmbushin detyrimet ligjore për të qenë prezent dhe për të dhënë përgjigje në mbledhjet e komisioneve të përhershme ose të posaçme, - janë vetëm disa nga treguesit kritikë, të cilët nxjerrin në pah hendekun ende të madh midis nevojës për forcimin e konceptit të parlamentarizmit dhe llogaridhënies, dialogut dhe bashkëpunimit konstruktiv, me sjelljen politike, paragjyquese, të njëanshme dhe cënuese ndaj vetë besimit tek institucioni i Kuvendit.

Në disa prej debateve, sidomos në komisionin e ligjeve, në komisioni hetimor për zgjedhjet 2021, etj, disa deputetë të opozitës patën preokupim më të madh mbajtjen e fjalimeve të gjata dhe lodhjen e pjesëmarrësve/publikut me çështje teknike e replika pa lidhje me thelbin e axhendës, sesa ndjekja e praktikave të mira të punës së parlamentit në komisione të tilla me interes publik. Abuzimi me kohën në dispozicion dhe përpjekja për të krijuar konflikt në çdo temë dhe për çdo detaj procedural, vetëm sa dobëson aktivitetin parlamentar dhe e bën jo efikas mesazhin që Kuvendi përcjell në publik. Nga ana tjetër, retorika e personalizuar, përfshirë termat denigrues ndaj deputetëve, patën për autor figurat më të rëndësishme të Kuvendit, përfshirë kryeministrin, ndonjë drejtues të grupeve parlamentare dhe të komisionit për median dhe edukimin. ISP, shoqëria civile, media dhe partnerë ndërkombëtarë reagojnë në mënyrë kritike ndaj gjesteve të tilla dhe ligjëritimit denigrues, kryesisht atij ndaj deputeteve në parlament, megjithatë vetë Kuvendi nuk ndërmori asnjë masë, nuk pati reagim institucional dhe nuk vuri në funksion asnjë prej mekanizmave të parashikuara nga Kodi i Sjelljes.

RASTI KRITIK I AK-së

Koncepti i transparencës mbi kandidaturat që votohen në Kuvend për poste të ndryshme kushtetuese është i lidhur edhe me nevojën që Kuvendi të përmirësojë standardet e plota të transparencës rreth kandidatëve, ku përfshihen CV e plotë e kandidatëve, të dhënat kryesore të tyre në kuadër të formularëve të dekriminalizimit, si dhe rekomandimet mbështetëse të institucioneve ose grupeve të tjera të interesit.

Praktika e zgjedhjes së drejtuesit të AK, shënoi hapa pas, për shkak se kandidati u votua në komisionin përkatës pa qenë i pranishëm, një praktikë që bie ndesh me standardet e mira parlamentare dhe me rolin e Kuvendit në praktikën zgjedhore. Pretendimet në mbledhje nga deputetë të secilit krah politik, për të ndryshuar praktikën dhe për ta përmirësuar atë në funksion të rritjes së transparencës dhe meritokracisë u refuzuan nga drejtuesi i komisionit, duke krijuar përshtypjen se kandidimi dhe zgjedhja e individit për këtë post ishte paracaktuar, zhvillim që cënon dhe dobëson rolin kushtetues dhe lidhës të Kuvendit në raste të tilla.

4. KUVENDI, TRANSPARENCA DHE PROBLEMATIKA

Në kuadër të parlamentit të hapur dhe mbështetjes që Kuvendi ka marrë nga institucione e donatorë të rëndësishëm, përfshirë projekti “Për mbështetjen e Parlamentit dhe Edukimin Qytetar” i Agjencisë Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim” (SDC), zbatuar nga Instituti Demokratik Amerikan (NDI) dhe nga Prezenca e OSCE në Shqipëri, Kuvendi është përballur me sfidën e ndryshimit pozitiv të standardeve të transparencës.

4.1. RISI DHE ELEMENTË POZITIVË NË ASPEKTIN E TRANSPARENCËS

Kuvendi ka shënuar progres domethënës në aspektet e risive teknologjike dhe përpjekjeve për të avancuar drejt standardeve më të larta të “open parliament”. Gjatë vitit të fundit Kuvendi publikoi të dhëna të përpunuara të detajuara dhe profesionale mbi produktin e vendimmarrjes dhe aktivitetit të tij, statistika të rëndësishme, të cilat më përpara krijoheshin dhe publikoheshin vetëm nga organizata monitoruese si Instituti i Studimeve Politike. Gjithashtu Kuvendi e zgjeroi shumëllojshmërinë e përdorimit të informacionit, duke ofruar të dhëna të detajuara për çdo seancë plenare (axhendë, njoftim, listën e diskutuesve, përmbledhje e punimeve, etj), praktikë që nuk është aplikuar në të kaluarën. Pozitiv është edhe përpunimi statistikor i të dhënave të parlamentit, në aspektin gjinor, ndarjes mazhorancës – opozitë, etj, si dhe një sërë broshurash dhe fletëpalosje informuese mbi parlamentin dhe rolin e tij.

- ❖ **Publikimi i votave.** Kuvendi vijon të publikojë votat e deputetëve në faqen online. Votat e publikuara përfshijnë aktet kryesore të parlamentit dhe publiku mund ti aksesojë në adresën online <http://parlament.al/VotaDeputet>. Sistemi i publikimit të votave gjithsesi nuk ofron të dhëna të sakta lidhur me prezencën reale të deputetëve në seancë, pasi bashkon në të njëjtën kategori si deputetët që nuk kanë qenë prezent në seancë, si edhe ata që nuk kanë marrë pjesë në votimin e akteve në momentin e votimit. Nga përvoja monitoruese parlamentare provohet se jo gjithnjë këto të dhëna (prezenca dhe mospjesëmarrja në votim) janë të njëjta.
- ❖ **Publikimi i dekretëve të Presidentit.** Në dallim nga institucioni i Presidentit, i cili sipas Kushtetutës, ka të drejtën e kthimit të ligjeve për rivotim në parlament, bazuar në

pretendime kushtetuese dhe ligjore, institucioni i Kuvendit ka qenë shumë më transparent dhe më praktik në informimin e publikut mbi numrin dhe emërtimin e akteve të kthyer nga Presidenti dhe vendimmarrjen përkatëse të Kuvendit. Të gjitha dekretet e Presidentit për rikthim ligjesh në Kuvend gjenden në linkun online të Kuvendit <http://parlament.al/LiqjeRishqyrtim>

❖ **Buletini informativ elektronik.** Kuvendi aplikoi publikimin online të një buletini përmbledhës (2 për sesion), duke ofruar të dhëna statistikore mbi vendimmarrjet, seancat, kohën e diskutimeve, etj. të dhënat e buletinit përbëjnë një zhvillim pozitiv në drejtim të informimit publik dhe transparencës. Një kopje e buletinit gjenden në linkun

<https://www.parlament.al/News/Index/15063>

❖ **Elementë pozitivë të transparencës.** Gjatë këtij sesioni parlamentar, Kuvendi është mbështetur në rritjen e elementëve të transparencës nga NDI dhe Prezenca e OSBE-së, të cilat në bashkëveprim po aplikojnë një program mbështetës për Kuvendin financiar nga Qeveria Zvicerane përmes projektit për Parlamentin dhe Edukimin Qytetar (PACEP).

Pjesë e këtij angazhimi janë disa përmirësime të rëndësishme informuese të Kuvendit, ku më kryesoret janë fletëpalosjet dhe broshurat informative mbi:

- Organizimi i Kuvendit: <https://www.parlament.al/Files/sAdministrata/Organet%20e%20Kuvendit.pdf>
- Procesi ligjvënës: <https://www.parlament.al/Files/sAdministrata/Procesi%20Ligjberes.pdf>
- Mandatet parlamentare: <https://www.parlament.al/Files/RaporteStatistika/mandatet.pdf>
- Deputetët në organet e Kuvendit:
<https://www.parlament.al/Files/RaporteStatistika/dptneorgkuvend.pdf>
- Komisionet e Përhershme:
<https://www.parlament.al/Files/sAdministrata/Komisionet%20e%20Perhershme.pdf>
- Përfaqësimi i grave: <http://parlament.al/Files/Informacione/grate.pdf>
- Seanca plenare: udhëzues <https://www.parlament.al/Files/Informacione/Shiko%20dokumentin.pdf>
- Buletini statistikor: <https://www.parlament.al/Files/Informacione/Buletini%20statistikor%202021-2025..pdf>
- Turi virtual në KSH: <https://www.parlament.al/News/Index/11602>

Përmes programeve të tjera të mbështetjes Kuvendi ka aplikuar edhe publikimin online të videove prezantuese të kandidatëve nga institucionet akademike për anëtar në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Videot prezantuese për disa nga anëtarët që kanë dhënë miratim paraprak gjenden online në faqen e internetit të Kuvendit.

Kjo praktikë pozitive do të duhej të aplikohet edhe për funksionet e tjera më të rëndësishme të Kuvendit, sidomos zgjedhja në institucione të rëndësishme me varësi direkte nga Kuvendi. Gjatë këtij sesioni Kuvendi ka zgjedhur anëtarë dhe kryetarin e AK, ka shpallur kandidime për Autoritetin e Dosjeve dhe Këshillin Drejtues të RTSH, për anëtar të Bordit të Bankës së Shqipërisë, etj, pra për një numër të madh institucionesh, por për asnjë rast të njëjtë nuk është aplikuar publikimi i modelit të videove prezantuese si në rastin e KLGJ dhe KLP.

4.2. PROBLEMATIKA ME STANDARDET E TRANSPARENCËS

Dhënia e informacionit nuk përbën gjithnjë tregues transparence nëse nuk jepet në kohë dhe në formën e përmbajtjen që kërkohet sipas ligjit dhe akteve rregullatore. Me informacionin janë të lidhura detyrimi i Kuvendit për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të komisioneve dhe të strukturave të tjera. Aktualisht (verifikimi në 15.01.2022) pjesa më e madhe e dokumenteve parlamentare janë të publikuara, por nga monitorimi aktiv rezulton se mungon ende një sistem solid dhe funksional i publikimit të procesverbaleve, sidomos pas mbledhjeve (në komisione, në Byronë e Kuvendit dhe në Konferencën e Kryetarëve), që janë të rëndësishme dhe ku merren vendime që kanë impakt e ndjeshmëri të larta publike.

Grupet monitoruese të ISP janë detyruar të ndjekin mbledhjet e komisioneve online përmes sistemit të ofruar nga parlamenti (përfshirë mbledhjet online në faqen e facebook), por përmes monitorimit online shtohen ndjeshëm vështirësitë për të mbajtur shënim deklaratimet dhe propozimet, si dhe për të evidentuar raste të ndërhyrjeve gjatë debatit, praninë e të gjithë deputetëve apo elementë të tjerë me rëndësi që lidhen me përmbajtjen dhe integritetin e mbledhjeve dhe të debateve. Vonesa në publikimin e procesverbaleve e vështirëson akoma më shumë identifikimin dhe monitorimin efektiv, të plotë dhe në kohë.

Për shembull, deri në 15.01.2022 nuk ishte publikuar ende asnjë procesverbal i mbledhjeve të komisioneve të përhershme pas periudhë 11 nëntor-31 dhjetor 2021. Disa komisione madje janë më të vonuara në publikime, megjithëse në këtë periudhë Kuvendi ka debatuar dhe miratuar një prej akteve më të rëndësishme vjetore, buxhetin e shtetit 2022.

Konkretisht, rezulton se:

- Komisioni i ligjeve (i fundit publikim, 11.11.2021)
- Komisioni i Ekonomisë (i fundit publikim, 08.11.2021)
- Komisioni i Integritetit (i fundit publikim, 12.10.2021)
- Komisioni i Sigurisë (i fundit publikim, 27.10.2021)
- Komisioni i Medias (i fundit publikim, 05.11.2021)
- Komisioni i Politikës së Jashtme (i fundit publikim, 03.11.2021)
- Komisioni i Vep. Prodhuese (i fundit publikim, 27.10.2021)
- Komisioni i Shëndetësisë (i fundit publikim, 01.11.2021)

Element tjetër që lidhet me transparencën, sidomos me njohjen për deputetët dhe funksionin zgjedhor të Kuvendit, është detyrimi për publikim të detajuar të CV-ve për deputetët dhe për kandidatët për poste që zgjidhen ose emërohen nga Kuvendi.

Në janar 2022, katër muaj pas nisjes së legjislaturës së re parlamentare, ende Kuvendi nuk ka plotësuar të dhënat online për deputetët. Një monitorim formal i faqes zyrtare të Kuvendit rezulton se në kategoritë kryesore publike ku kërkohen të dhënat e deputetëve dhe kontaktet me ta, mungojnë të dhënat minimale për më shumë se

gjysmën e deputetëve, struktura si sekretariatet dhe komisionet, si dhe 98% të rasteve të përbërjes parlamentare, sidomos të të dhënave me foto dhe adresë kontakti.

Një pjesë e të dhënave, si përbërja dhe adresa e e-mail-it janë përfshirë në broshurat informative të hartuara nga Kuvendi, por pasqyrimi i plotë i të dhënave në faqen qendrore që njih dhe përdor publiku i interesuar, përbën detyrim dhe një praktikë parlamentare bashkëkohore. Broshurat informative vlejné për individët, mediat dhe organizatat që kanë më shumë kohë e vëmendje ndaj aktivitetit parlamentar, kurse publikimet e plota në kategorinë kryesore “e parlament”, “kontakto deputetin tënd” apo tek përbërjet e grupeve parlamentare dhe tek kategoria “deputetët” do të kishin qenë shumë më të këshillueshme dhe më efektive.

Së fundi, Kuvendi publikon procesverbalet e seancave plenare dhe më vete dhe mënyrën sesi kanë diskutuar deputetët. Për efekt dokumentar dhe studimor Kuvendi duhet të ndryshojë praktikën e publikimit të procesverbaleve, duke përfshirë në çdo votim të dhënat shifrore të votimit të çdo akti. Kur drejtuesi i seancës deklaron se akti ligjor u miratua, duhet deklaruar me zë dhe shënuar në procesverbal sa është numri i votave pro, kundër, abstenuese dhe prezenca në sallë në momentin e votimit.

Mungesa e këtyre të dhënave e dëmton konceptin e dokumentacionit parlamentar dhe vështirëson lidhjen e të dhënave midis akteve, seancës dhe tabelës së votimit, tri dokumente të ndryshme që prodhohen nga i njëjti institucion.

Deputeti Saimir Korreshi (PD) bëri headline në media me mënyrën e tij të diskutimeve në parlament. Ai fitoi simpati publike për gjuhën direkte dhe problematikën e ngritura, të cilat bënë dallim nga tradita e fjalimeve të gatshme dhe formale në parlament.

Deputeti Erion Braçe (PS) ishte nga deputetët më aktiv në debatet për buxhetin dhe axhendën parlamentare, por edhe nga deputetët e paktë kritikë ndaj disa akteve të qeverisë. Ai inicioi disa amendamente ligjore në çështjet e buxhetit, duke marrë mbështetje mediatike dhe në disa raste edhe nga opozita.

Deputet tjetër i mazhorancës që shfaqti qëndrime konstruktive ishte edhe **Fatmir Xhafaj (PS)** (debatet për drejtësinë).

4.3. DEBAT GJATË GJITHË NATËS PËR QEVERINË?

Një prej akteve të rëndësishme të sesionit të ri parlamentar ishte miratimi i përbërjes dhe programit të qeverisë së re. Praktika e shqyrtimit dhe e miratimit, sidomos në rastin e legjislaturave të reja dhe ekzistencës së një mazhorance të qartë mbështetëse, është gati formale. Në raste të tilla më shumë vlerë merr solemniteti, sesa elementët e përmbajtjes. ISP shprehu shqetësimin publik kur konstatoi se ky akt me rëndësi në jetën e parlamentit dhe me rëndësi sidomos për interesat qytetare, u trajtua në mënyrë të sforcuar dhe jo serioze, duke vijuar diskutimet parlamentare gjatë gjithë natës deri në orët e para të mëngjesit.

Diskutimet natën e bëjnë të pamundur ndjekjen nga qytetarët dhe media, dhe e kthejnë parlamentin në një organ mekanik, ku fjalimet kalojnë për shkak të procedurës dhe deputetët flasin për një auditor që mungon. Në praktikën e vendeve të tjera dhe në Shqipëri, ka pasur raste specifike të debateve gjatë natës, por kanë qenë raste emergjente ose praktika abuzive politike, të cilat janë kritikuar. Në rastin konkret nuk kishte ndonjë emergjencë kombëtare dhe as justifikim për seanca të tilla.

4.4. KUVENDI, ASNJË DEKLARIM NË REGJISTRIN E KONFLIKTIT TË INTERESIT

Gjatë sesionit të fundit parlamentar nuk pati asnjë deklaram në regjistrin e konfliktit të interesit, në regjistrin e dhuratave dhe as në pjesëmarrjen në veprimtari të të tretëve. Nëse nuk ka pasur raste të tilla është normale të mos ketë deklarime. Megjithatë, burime të ndryshme nga media dhe shoqëria civile, përfshirë ISP-në, kanë ngritur shqetësime në disa raste nëse kemi të bëjmë me situatë në konflikt interesi.

Një prej tyre ishte nisma e deputetëve të mazhorancës për të ndryshuar mandatin kushtetues të KPK, struktura e parë e vettingut në drejtësi. Një prej deputeteve nënshkruese të nismës dhe kryetarja e KPK janë motra. Një situatë e tillë, në të cilën motra inicion ndryshime kushtetuese dhe ligjore për zgjatjen e mandatit për motrën, mund të konsiderohet gjendje e mundshme në konflikt interesi. ISP u konsultua paraprakisht me ILDKPKI dhe ekspertë e njohës të Kuvendit dhe ata e konfirmuan këtë shqetësim. Megjithatë vetë Kuvendi nuk bëri ndonjë hetim administrativ dhe deputetja nuk ka bërë deklaram në Regjistrin e Konfliktit të Interesit.

Gjithashtu gjatë sesionit ka pasur raste të tjera kur deputetë aktiv në biznesin privat, kanë marrë pjesë në debatet rreth buxhetit ose në akte të ndryshme parlamentare që mund të kenë ndikim direkt ose indirekt në aktivitetin financiar privat. Edhe në praktika të tilla nuk ka pasur ndonjë deklaram, nëse ndonjë deputet gjendet në konflikt interesi.

Në ISP ka pasur denoncime të ndryshme, përfshirë rastin kur deputetë që kanë angazhime part-time në një institucion universitar, pronari i të cilit vlerësohet në seancë dëgjimore edhe nga vetë deputeti/deputetët, gjithsesi hetimet e deritanishme nuk kanë arritur të provojnë gjendjen në konflikt interesi.

Deputeti Bujar Çela (PS) u bë protagonist në deklaramet e tij publike dhe në diskutimet në komisionin parlamentar pro diktatorit Hoxha, deklaram që me të drejtë shkaktoi kritika publike dhe vuri në dyshim vullnetin e parlamentit për të respektuar rezolutat dhe aktet e miratuara prej tij lidhur me krimet e komunizmit. Kuvendi premtoi trajtimin e rastit në aspektin e etikës, megjithatë nuk pati akt serioz publik prej tij.

Deputeti Ervin Salianji (PD) tentoi të sulmojë një deputet të mazhorancës gjatë një diskutimi parlamentar, një sjellje që vjen ndesh me Kodin e Etikës dhe standardet parlamentare. **Kryeministri Rama** përdori fjalor denigrues ndaj deputetes Jorida Tabaku, **deputeti Gjekmarkaj (PD)** u kritikua për gjuhë denigruese, por në këto dhe raste të tjera të ngjashme Kuvendi nuk arriti të zbatojë parimet e Kodit të Etikës.

4.5. INTERPELANCAT DHE PROBLEMATIKA E TYRE

Institucioni i interpelancave parlamentare është mjet i rëndësishëm për të ushtruar kontrollin kushtetues dhe kontrollin e pushtetit ekzekutiv. Deputetët e përdorin atë për tema e çështje me rëndësi, por kryesisht si aksion dhe qëndrim politik, kryesisht i opozitës. Në sesionin e fundit parlamentar u regjistruan pesë kërkesa për interpelancë, nga të cilat, tre u zhvilluan dhe dy mbeten në procedurë. Deputeti Ferdinand Xhaferaj zhvilloi interpelancë me ministrat Balluku dhe Ahmetaj, deputeti Tritan Shehu zhvilloi dy interpelanca, me ministren Manastirliu dhe kryeministrin Rama.

Në tre rastet interpelancat u zhvilluan sipas parashikimit në axhendë, por në tërësi sjellja politike ndaj institucionit të interpelancës mbetet abuzuese. Devijimet procedurale dhe retorika që shoqëron debatin nuk merret me thelbin e problemit, por kryesisht zhvendoset në sulme personale dhe etiketime, të cilat dëmtojnë sa institucionin e interpelancës aq edhe prestigjin publik të Kuvendit. Një zhvillim i tillë ndodhi edhe me interpelancën e Xhaferaj me zv/kryeministrin Ahmetaj, gjatë të cilës, jashtë rregullave të Kuvendit, mori fjalën edhe kryeministri. Ky i fundit u lejua të flasë, pavarësisht se interpelancë nuk ishte me të, si dhe përdori një retorikë denigruese ndaj kritikave të ardhura nga deputeti i opozitës.

Një problematikë tjetër me interpelancat lidhet me praktikën e tanishme parlamentare, sipas të cilës, kërkesa për të pasur kryeministrin në interpelancë zhvendoset në paraqitjen e ministres së shtetit pranë kryeministrit në vend të vetë kryeministrit. Ndonëse kjo praktikë lejohet, në thelb përbën devijim nga objekti dhe rëndësia e interpelancës.

Kryeministri është drejtuesi më i lartë i qeverisë, pas tij vjen zv/kryeministri, ministri i shtetit është i rëndësishëm, por nuk e ka përgjegjësinë dhe autoritetin e titullarit kryesor të qeverisë. Për më tepër, përgjigjet që jepen nga ministria e shtetit janë të natyrës politike, kryesisht deklarata konsumi ditor, ndërkohë që përgjigjet që mund e duhet të vijnë nga kryeministri janë shumë më komplekse, me elementë teknike, ligjore dhe politike. Për pasojë, duhet marrë në konsideratë vendimi i deputetit Vangjel Dule (PBDNJ) për të mos pranuar vijimin e interpelancës së tij me ministren e shtetit ndërkohë që ai kishte kërkuar interpelancë me kryeministrin.

Më 16 dhjetor 2021 u zhvillua debati me pyetje-përgjigje me Ministren e Arsimit dhe Sportit kërkuar nga deputetja Erisa Xhixho (LSI). Ky është një rast pozitiv i përdorimit të instrumentit të pyetjeve nga deputetja në funksion të rritjes së llogaridhënies, praktikë që do të ishte e dobishme të kishte përdorim më të gjerë edhe nga deputetët e tjerë.

4.6. KËRKESA PËR INFORMACION: VETËM 10 NGA 140 DEPUTETË

Deputetët kanë të drejtë të kërkojnë informacione nga institucionet dhe Kuvendi ka detyrimin e ndërmjetësimit të dhënies së informacioneve brenda një afati të arsyeshëm kohor të parashikuar nga ligji dhe aktet nënligjore. Këtë të drejtë në sesionin aktual parlamentar e përdorën në 49 raste, 10 nga 140 deputetë. Konkretisht, deputeti Ervin Salianji (PD) adresoi 11 kërkesa për informacion, deputetët Albana Vokshi dhe Zef Hila (PD) adresuan nga 8 kërkesa për informacion, deputetja Jorida Tabaku (PD) adresoi 7 kërkesa për informacion, deputeti Helidon Bushati (PD) adresoi 6 kërkesa për informacion, deputetët Bujar Leskaj (PD) dhe Antoneta Dhima (PS) adresuan nga dy kërkesa për informacion, deputeti Erion Braçe (PS) adresoi 2 kërkesa për informacion, si dhe deputetët Gazment Bardhi dhe Agron Gjekmarkaj (PD) adresuan nga 1 kërkesë për informacion, ky i fundit në bashkëautorësi.

4.7. BERISHA, DE FACTO NUK USHROI FUNKSIONIN E DEPUTETIT

Në debatin mbi pezullimin e deputetit Berisha nga grupi parlamentar i PD, argument kryesor është përdorur kërkesa amerikane që z.Berisha të mos ishte deputet aktiv në këtë parti. Vendimi politik nuk mund të lidhej me mandatin parlamentar, ndaj vendimi i pezullimit nuk ndikon në pozitën kushtetuese të deputetit Berisha. Megjithatë, nga të dhënat monitoruese të sesionit të fundit parlamentar, rezulton se deputeti Berisha nuk e ushtroi *de facto* mandatin parlamentar, - ai nuk mori pjesë në 99% të seancave plenare, nuk votoi asnjë ligj dhe akt parlamentar, nuk mori pjesë në asnjë mbledhje komisioni, nuk inicioi asnjë akt ligjor dhe nuk pati asnjë deklaram me cilësinë e deputetit.

Aktiviteti i tij politik ishte mjaft intensiv brenda PD-së, duke surprizuar monitoruesit e jetës politike. Ai zhvilloi mbi 30 takime publike dhe brenda një kohe të shkurtër udhëtoi në të gjitha qytetet kryesore të vendit, nga jugu në veri, duke promovuar idetë e tij politike lidhur me demokracinë e brendshme në PD. Kuvendi i thirrur prej tij në 11 dhjetor shënoi pikën kulmore të angazhimit, ndërkohë që më 18 dhjetor ai dhe mbështetës të tij organizuan një referendum brenda PD-së lidhur me mandatin e kryetarit aktual të kësaj partie. Pavarësisht natyrës së këtyre akteve, ISP mund të vlerësojë se deputeti Berisha nuk ushtroi funksionin e tij parlamentar, por i dha prioritet funksionit të tij publik dhe politik.

4.8. NISMAT PARLAMENTARE: 3 NISMA DHE DISA PROBLEMATIKA

Një nga të drejtat dhe përgjegjësitë thelbësore të deputetëve është inicimi i nismave ligjore, pra procesi ligjvënës, jo vetëm përmes debatit dhe votimit, por edhe përmes propozimeve konkrete. Edhe në këtë sesion parlamentar qeveria ishte burimi kryesor i nismave legjislative dhe Shqipëria vijon të jetë një prej vendeve me numrin më të minimal të nismave ligjore nga deputetët.

Referuar të dhënave të Kuvendit, deputetët Agron Duka dhe Ismet Beqiraj ishin të vetmit që iniciuan ndryshime ligjore përmes deponimit të nismave ligjore. Zoti Duka, i cili është kryetar i PAA-së, inicioi dy amendamente ligjore që lidhen me problematika të biznesit dhe të bujqësisë, (për ndryshime në ligjin 92/2014 për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH, si dhe për ndryshime në ligjin 9817/2007 për bujqësinë dhe zhvillimin rural. Nga ana tjetër deputeti Beqiraj, i cili në zonën e tij elektorale (qarku Fier) inicioi ndryshime ligjore në urdhrin e inxhinierit hidroteknik në RSH. Secila nismë u propozua në tetor 2021 dhe në vetvete përbëjnë zhvillime pozitive sepse forcojnë konceptin e përfaqësimit lokal dhe të kategorive të ndryshme sociale.

Disa nisma të tjera parlamentare janë bërë nga deputetë të veçantë, por në thelbin e tyre ato janë nisma të grupeve parlamentare ose të grupeve të tjera, të përfaqësuara nga deputeti në parlament. Në tabelën bashkëngjitur janë paraqitur nismat indirekte ose kolektive të deputetëve.

DEPUTETËT	AKTI LIGJOR
<i>ERISA XHIXHO (LSI)</i>	<i>PROJEKTLIGJ "PËR REGJISTRIN KOMBËTAR TË TË DËNUARVE PËR KRIME SEKSUALE"</i>
<i>ARBEN PËLLUMBI (PS)</i>	<i>PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN "PËR INVESTIMET STRATEGJIKE"</i>
<i>ALFRED RUSHAJ (PD)</i>	<i>PROJEKTLIGJ "PËR NJË SHITESË NË LIGJIN "PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR"</i>
<i>ALFRED RUSHAJ (PD)</i>	<i>PROJEKTLIGJ "PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME KUSHTETUTËN E RSH"</i>
<i>39 DEPUTETË (PS)</i>	<i>PROJEKTLIGJ "PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME KUSHTETUTËN E RSH"</i>
<i>KLOTILDA FERHATI (PS)</i>	<i>PROJEKTLIGJ "PËR PADITË KOLEKTIVE"</i>

Nisma për Regjistrin Kombëtar të të Dënuarve për Krime Seksuale, paraqitur nga deputetja Xhixho, është përsëritur më parë (19.02.2021) nga ish-deputetja Fatjona Dhimitri. Nisma ka qëndruar në Kuvend deri në mbylljen e legjislaturës, dhe për shkak se në legjislaturën e re nuk bën pjesë deputetja Dhimitri, nisma është konsideruar e kthyer tek iniciuesi. Grupi lobues ka gjetur mbështetje tek deputetja aktuale Xhixho për ta rikthyer atë përsëri në axhendën parlamentare.

Një nga shqetësimet lidhur me axhendën ligjvënëse është mënyra sesi Kuvendi operon me nismat ligjore të ardhura nga deputetët. Në praktikën parlamentare kur deputeti iniciues dorëzon mandatin ose nuk është rizgjedhur më, nisma parlamentare bie automatikisht. Nëse nisma ka mbështetje ose nxitje nga ndonjë grup interesi ose institucion, këto të fundit duhet të gjejnë deputet tjetër mbështetës dhe ta përsërisin nismën parlamentare nga fillimi.

Midis nismave të pakonsumuara në legjislaturën e kaluar (19 në total në vitet 2017-2021) bëjnë pjesë edhe nisma ligjore serioze që kanë të bëjnë me problematika që duhen trajtuar, si për shembull, nisma e muajit prill 2021 e ish-deputetit Adnor Shameti, për ndryshim në ligjin 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar. Kur Kuvendi bëri ndryshime në legjislativën e reformës në drejtësi, Komisioni i Ligjeve dhe Ministria e Drejtësisë nuk përfshiu në lobim dhe procedurë problematikën e konstatuar nga Inspektorati i Lartë i Drejtësisë (ILD), pavarësisht se ato ishin pjesë e kërkesave dhe sugjerimeve të paraqitura në Kuvend nga organet e drejtësisë. Pas miratimit të ndryshimeve Kuvendi e pranoi gabimin dhe për rrjedhojë deputeti Shameti mori nismën formale për sjelljen e draftit përmirësues që përfshin edhe ILD-në në parlament. Për shkak se iniciuesi nuk është zgjedhur më deputet, nisma e tij bie automatikisht

dhe parlamenti do të duhet ta presë që një ose disa deputetë të tjerë të rimarrin nismën për ta përfshirë në axhendën parlamentare.

4.9. PS DHE PD, NISMA PËR NDRYSHIMIN E KUSHTETUTËS

Gjatë sesionit të ri të legjislaturës aktuale parlamentare dy partitë e mëdha iniciuan ndryshime të reja në Kushtetutën e RSH. Grupi parlamentar i PS, përmes 39 deputetëve, inicioi ndryshimin e mandatit kushtetues të strukturave të nivelit të parë të vettingut në drejtësi, duke shtyrë mandatin e tyre për dy vjet. Nisma erdhi si sugjerim i institucioneve ndërkombëtare që asistojnë reformën në drejtësi, si dhe kërkesë e vetë institucioneve të drejtësisë. Ajo do të duhej të kalohej me votë konsensuale, siç është miratuar edhe reforma në drejtësi, megjithatë Partia Socialiste synoi të përfitojë politikisht duke e paraqitur si nismë të saj.

Nisma ka kaluar sipas procedurës parlamentare, në opinion në Komisionin e Venecias si dhe në konsultime me grupe të ndryshme interesi. Instituti i Studimeve Politike (ISP) u ftua në seancë dëgjimore lidhur me opinionet për nismën, duke qenë organizata e vetme pjesëmarrëse në seancën përkatëse dëgjimore me shoqërinë civile. ISP i adresoi vlerësimet dhe rekomandimet e saj edhe në rrugë zyrtare.

Nisma e dytë erdhi nga partia kryesore e opozitës, Partia Demokratike. Synimi i nismës është rikthimi i konceptit të vettingut në politikë, përmes ndërhyrjeve të reja në Kushtetutë dhe në disa ligje. Nisma është përsëritur më 2018, megjithatë tani vjen në një kontekst të ri politik. Ndryshe nga nisma e parë, e cila ka mbështetje të gjerë ndërkombëtare dhe konsensus më të gjerë, nisma e dytë ka mbështetje publike, por nuk ka konsensus politik dhe as mbështetje të fortë ndërkombëtare. Rezervat lidhen kryesisht me përputhshmërinë e koncepteve të vettingut në politikë me parimet dhe normat kushtetuese, si dhe me praktikën eksperimentale që synohet të arrihet përmes ndryshimit të Kushtetutës. Nisma ka kaluar për opinion në Komisionin e Venecias dhe ende nuk kanë nisur praktikat parlamentare të konsultimit publik.

4.10. NISMAT PËR KOMISIONE HETIMORE

Deputetët e PD-së paraqitën tri nisma, - tre komisione hetimore ("Për të kontrolluar ligjshmërinë e veprimeve administrative dhe procedurës së ndjekur nga ana e organeve ekzekutive në procedurat për ndërtimin dhe administrimin e impianteve të trajfimit të mbetjeve urbane në Tiranë, Elbasan dhe Fier", "Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve dhe mosveprimeve të institucioneve shtetërore dhe funksionarëve publikë në çështjet që kanë sjellë si pasojë vendimin e arbitrazhit "Becchetti dhe të tjerë kundër Shqipërisë", si dhe "Për kontrollin e keqpërdorimit të burimeve të administratës shtetërore, si dhe të asgjësimit të kufirit midis shtetit dhe partisë socialiste në pushtet për qëllime elektorale në zgjedhjet e 25 prillit 2021". Nisma e parë u miratua dhe është në proces, nisma e dytë u refuzua, nisma e tretë u miratua dhe është në proces, por me emërtim të ndryshëm të objektit të komisionit.

Nga ecuria e deritanishme e punimeve të dy komisioneve hetimore rezultojnë se nuk pritet të ketë rezultate konkrete dhe se qëndrimet e kundërta politike pritet ta kushtëzojnë edhe produktin e komisioneve. Nëse në rastin e parë (impiantet e trajtimit të mbetjeve urbane), tashmë është konfirmuar ekzistenca e veprave penale, pasi SPAK vendosi një sekustro dhe arrestimin e ish -ministrit Koka, në rastin e hetimit të shkeljeve për zgjedhjet parlamentare të 25 prillit nuk ka pasur progres dhe nuk pritet të ketë ndryshime qëndrimesh dhe as përfshirje serioze të prokurorisë në hetimet e rasteve të pretenduara të krimit zgjedhor.

4.11. DISA PROBLEMATIKA LIDHUR ME FUNKSIONIN ZGJEDHOR TË KUVENDIT

Zgjedhja e një prej anëtarëve të Autoritetit të Konkurrencës krijon shqetësim lidhur me mënyrën sesi parlamenti i trajton praktikën dhe standardet zgjedhore. Më 20 tetor 2020 komisioni përgjegjës në parlament zhvilloi seancë dëgjimore me dy kandidatët e ardhur nga Presidenti dhe vendosi kalimin e tyre për votim në seancë. Pas një viti, më 4 tetor 2021, parlamenti i ri zhvilloi një seancë tjetër dëgjimore me të njëjtin kandidat dhe për të njëjtin vend vakant, me argumentin se seanca e parë është mbajtur në kushtet e ekzistencës së një parlamenti tashmë të shpërndarë dhe parlamenti i ri duhet të aplikojë procedurën nga fillimi. Kjo praktikë krijon probleme sepse vetë parlamenti është përgjegjës që nuk ka përmbushur detyrën e tij ligjore nga tetori 2020 në korrik 2021, si dhe përsëritja e seancës dëgjimore nga kandidatët sjell formalitet dhe krijon një precedent për të ardhmen.

Edhe në rastin e zgjedhjes së kryetarit të Autoritetit të Konkurrencës, praktika zgjedhore u shoqërua me probleme, nga fakti se një kandidat i pavarur, ish-zyrtar politik i zgjedhur nga parlamenti në legjislaturë të mëparshme tashmë propozohet nga 28 deputetë të një partie politike, deri tek fakti se ndryshe nga praktikën e mira parlamentare kandidati nuk u thirr në seancë dëgjimore dhe deputetët morën vendim për të pa pasur mundësi të njohin opinionet e tij, të marrin përgjigje për pyetjet e shqetësimit dhe as të njohin në mënyrë të detajuar CV-në dhe programin e tij në funksionin të detyrës së re për të cilën do të duhej të zgjidhej.

Nga ana tjetër, parlamenti vijon të mos përmbushë detyrimet e tij ligjore për zgjedhjen në kohë të individëve që bëjnë pjesë në institucione me burim parlamentin. Rasti më flagrant është ai i anëtarit të Autoritetit të Dosjeve, vend vakant prej disa vitesh dhe që as parlamenti aktual nuk ka arritur ende të marrë një vendim final. Praktikën e mira të zgjedhjeve sugjerojnë fillimin e hershëm të procedurës për t'i dhënë mundësinë zgjedhjes/vendimmarrjes në momentin që mbaron mandati zyrtar. Një sërë postesh, përfshirë edhe institucionin e cituar më lart, nuk janë zgjedhur në afatin e skadimit të mandatit ligjor, kjo kryesisht jo për shkaqe teknike, por për shkak të lobimeve politike në parlament, sidomos në radhët e mazhorancës. Të njëjtat vlerësime mund të thuheshin edhe për poste të tjera në dispozicion të Kuvendit.

4.12. VOTIMI I AKTEVE: 58 DEPUTETË 100%, KRYETARËT NË KUOTA KRITIKE

Pjesëmarrja në votime dhe identifikimi i deputetit me qëndrimin politik që mban me votën e tij në parlament është kriter vlerësimi në standardet e vendeve demokratike për cilësinë e angazhimit parlamentar. Në traditën tonë pjesëmarrja dhe vota nuk ka ndonjë rëndësi dhe as domethënie të veçantë, sidomos në rastet kur vota është thujtë e orientuar sipas linjës politike dhe pjesëmarrja ose jo nuk e ndryshon raportin e forcave politike pro dhe kundër një akti në parlament. Në rastin tonë kanë vlerë disa detaje të tjera, siç referohen votat e kryetarëve të partive politike në sesionin e fundit parlamentar, si dhe bashkë me ta edhe rasti Berisha, i vetmi deputet që nuk ka votuar asnjë akt në parlament gjatë katër muajve të fundit.

EMRI I DEPUTETIT	PARTIA	NE %
SALI BERISHA	PAV	0%
LULZIM BASHA	PD	17%
FATMIR MEDIU	PR	44%
AGRON DUKA	PAA	50%
DASHAMIR SHEHI	LZHK	56%
MONIKA KRYEMADHI	LSI	57%
EDI RAMA	PS	59%
SHPËTIM IDRIZI	PDIU	70%
VANGJEL DULE	PDBNJ	70%

Një e dhënë interesante është se vetë kryeministri ka marrë pjesë në votime vetëm në 59% të akteve parlamentare, pavarësisht se në standardet e mira parlamentare kryeministrat janë pjesëmarrës në kuota maksimale. Zoti Rama ka pasur kuota të larta mospjesëmarrjeje edhe në legjislaturën e kaluar, kryesisht për shkak të mungesës së presionit dhe nevojës për të qenë i pranishëm në akte që janë parashtruar për shkak të raporteve të sigurta mbështetëse për mazhorancën në parlament. Nga të dhënat e deputetëve që kanë votuar rreth 54 akte parlamentare rezulton se disa prej tyre kanë votuar më pak se në një të tretën e rasteve (Berisha, Basha, Çela, Bylykbashi, Likaj, Paloka, Duma dhe Bushati), ndërkohë që 58 deputetë (kryesisht të PS-së) kanë votuar në 100% të rasteve në seancat plenare dhe natyrisht 100% pro qëndrimit zyrtar politik të subjektit politik. Nga kryetarët e partive të opozitës, Basha e Mediu kanë gjithashtu kuotat më të ulta të pjesëmarrjes në votime, si dhe Idrizi dhe Dule kanë kuotat më të larta.

5. KOMISIONET PARLAMENTARE: BILANCI DHE PROBLEMATIKA

Sesioni parlamentar riktheu normalitetin në aktivitetin e komisioneve parlamentare, me pjesëmarrjen e të gjithë partive politike parlamentare. Komisionet në tërësinë e tyre vepruan konform axhendës së parlamentit, si dhe të gjitha mbledhjet e tyre u publikuan në faqen online të Kuvendit në mediat sociale. Për shkak të rëndësisë së debatit në komisione ato morën vëmendje të madhe mediatike dhe publike.

5.1. PROBLEMATIKA TË PJESËMARRJES NË KOMISIONE

Ndryshimet në Rregullore u mundësojnë deputetëve të jenë njëherësh në më shumë se një komision të përhershëm parlamentar, ndërkohë që Rregullorja parashikon përgjegjësinë e çdo deputeti për të qenë së paku anëtar në një prej komisioneve të përhershme. Nga të dhënat monitoruese rezulton se disa deputetë nuk janë anëtarë të komisioneve (Sali Berisha, Monika Kryemadhi), disa të tjerë nuk marrin pjesë në asnjë mbledhje komisioni (psh, Edi Paloka), ndërkohë që ka deputetë aktiv në më shumë se dy komisione.

Një nga paradokset e organizimit dhe ndarjes së deputetëve në komisione është rasti i komisionit të integritetit, ku p.sh, kryetarja e komisionit të politikës së jashtme është anëtare e këtij komisioni. Akte të veçanta që kalojnë në komisionin e politikës së jashtme kalojnë edhe në komisionin e integritetit, ku i njëjti deputet ka dy role dhe dy vota. Të tilla praktika të mospërputhjeve dhe të votimit të deputetëve në dy komisione të ndryshme, krijojnë përshtypjen e ciklit të mbyllur të promovimit të deputetëve dhe të shqetësimit lidhur me integritetin e vendimmarrës ndaj akteve, sidomos atyre që kanë sensibilitet publik e politik.

Prania e deputetëve njëkohësisht në më shumë se një komision dhe axhenda e ngjeshur e mbledhjeve paralele të komisioneve shpesh kufizon praninë e deputetëve dhe mundësinë e tyre për të qenë aktiv në dy komisione me problematika, tematika dhe rend të ndryshëm ditor.

DEPUTETËT MË AKTIVË NË KOMISIONE

(duke përfshirë kryetarët e komisioneve):

Partia Socialiste

Bardhyl Kollçaku (PS), Antoneta Dhima (PS), Alqi Bllako (PS), Blerina Gjylameti (PS), Xhemal Qefalia (PS), Petro Koçi (PS), Etilda Gjonaj (PS), Etjen Xhafaj (PS), Baftjar Zeqo (PS), Erion Braçe (PS), Ismet Beqiraj (PS).

Partia Demokratike

Luçiano Boçi (PD), Ina Zhupa (PD), Helidon Bushati (PD), Ferdinand Xhaferaj (PD), Flutura Açka (PD), Ervin Salianji (PD), Edmond Spaho (PD), Emilja Koliqi (PD), Fatjon Veizaj (PD), Kreshnik Çollaku (PD), Arbi Agalliu (PD), Xhelal Mziu (PD), Bujar Leskaj (PD).

Gjatë debateve për buxhetin ka pasur disa raportime kritike në media lidhur me standardet e konsultimeve publike. Për shembull, Dhoma Amerikane e Tregtisë përmes një deklarata shprehu zhgënjimin e saj për mënyrën e paraqitjes së paketës fiskale 2022, praktikë e cila sipas DHA vjen në shkëlqje të ligjit nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin publik", i cili i kërkon autoriteteve shtetërore t'i ofrojnë palëve të interesuara një periudhë kohore të përcaktuar për të shqyrtuar dhe ofruar rekomandimet e tyre në lidhje me projekt-ligjin/et e propozuara.

DEPUTETËT MË PAK AKTIV NË KOMISIONE:

Gertjan Deda (PSD), Gledis Çeliku (PSD), Orinaldo Rakipi (PS), Meri Markiçi (PSD), Niko Kuri (PS), Agron Çela (LSI), Nustret Avdulla (PDIU), Edi Paloka (PD), Agron Shehaj (PD), Blendi Klosi (PS), Bujar Çela (PS), Rrahman Rraja (PS), Greta Bardeli

Në një rast tjetër media raportoi se grupet lobuese ndikuan në mënyrë informale në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave për të ndryshuar taksën e re për qumështin. Lobimi nuk është aktivitet i ndaluar, por shqetësim shkaktoi njoftimi se bisedimet ishin zhvilluar në një mbledhje informale të Komisionit, mbledhje që nuk bënte pjesë në axhendën e punës dhe për të cilën nuk kishte deklarime ose njoftime publike. Përmes mediave sociale u lajmërua fillimisht më 4 nëntor se ishte arritur dakordësia në negociatë, por pasi media raportoi në mënyrë kritike, deputetët deklaruan se bisedimet kanë qenë informale. Për ta bërë legjitime, disa ditë më pas komisioni organizoi seancë dëgjimore me grupin lobues, por tashmë dakordësia ishte arritur dhe séance ishte vetëm formale.

Një problematikë tjetër lidhet me integritetin e debatit dhe të mbledhjeve të komisioneve. Në disa raste dhe në disa komisione drejtuesit e tyre, por edhe të ftuarit, kryesisht ministra dhe zyrtarë të lartë ekzekutivë, shkëmbejnë replika politike që shpesh kalojnë në etiketime, fyerje dhe ligjërim të papërshtatshme me klimën e punës në një komision parlamentar. Të tilla ishin rastet e debatit në Komisionin e Ligjeve midis disa deputetëve të opozitës dhe zv/ministrit Bejtja, në komisionin e Sigurisë midis drejtuesit, opozitës dhe ministrit të brendshëm, në komisionin e shëndetësisë midis drejtuesit dhe ministres përkatëse, etj.

Në disa raste, si në komisionin e ligjeve me zv/ministrin, në komisionin e ekonomisë për shkak të replikave midis drejtuesit dhe përfaqësuesit të opozitës, etj, retorika e ashpër çoi në detyrimin për të ndaluar mbledhjen e komisionit deri në qetësimin e gjendjes. Ndërkohë ka komisione, si ai i integritetit dhe i politikës së jashtme, ku diskutimet janë shumë më racionale dhe deputetët dhe zyrtarët e ftuar për raportime shfaqin etikë në komunikim edhe respekt institucional.

Të gjithë drejtuesit e komisioneve të përhershme parlamentare kanë qenë e mbeten aktiv në mbledhjet e komisioneve, megjithatë monitorimi tregon se një listë tjetër deputetësh gjithashtu kanë qenë aktiv dhe kanë ushtruar në maksimum përgjegjësitë e funksionit parlamentar në komisionet parlamentare.

6. KLASIFIKIMI I EFIKASITETIT TË DEPUTETËVE (SHTATOR – DHJETOR 2021)

Në vijim të traditës së ndjekur nga ISP gjatë legjislaturës së kaluar, edhe këtë sesion parlamentar grupi monitorues aplikoi metodologjinë e vlerësimit të deputetëve bazuar në nivelet e efikasitetit parlamentar. Në kriteret e vlerësimit përfshihen kontributet e deputetëve në iniciimin e ligjeve të reja, të nismave të ndryshme, të angazhimit në komisione dhe në seanca, të ushtrimit të mekanizmave parlamentare të kontrollit dhe përfaqësimit, si dhe për rolin e tyre publik e mediatik. Kriter vlerësimi negativ ishin rastet e përfshirjes së deputetëve në incidente ose akte që çënojnë standardet etike të Kuvendit.

Instituti i Studimeve Politike dhe platforma monitoruese www.deputetim.al bazuar në këto kritere dhe duke u dhënë përparësi vlerësimit pozitiv (nisma ligjore me 10 pikë, amendimet ligjore dhe propozime politike në seancë ose në komision me 10 pikë, interpelancat dhe pyetjet në seancë me 10 pikë, votimi i ligjeve dhe akteve në seancë me 10 pikë, pyetje ose kërkesa për informacion adresuar institucioneve me 10 pikë, aktiviteti në zonën elektorale dhe veprimtaria në publik me 10 pikë, fjalime dhe angazhime në seancat plenare me 20 pikë (ku bëhet dallim midis nismave si individ dhe fjalimeve në emër të grupit) si dhe angazhimi në formë pjesëmarrjeje dhe diskutimesh në komisionet parlamentare me 20 pikë.

KRITERET E VLERËSIMIT	PIKËT
<i>NISMA LIGJORE</i>	10
<i>AMENDIME / PROPOZIME</i>	10
<i>INTERPELANCA / PYETJE NË SEANCË</i>	10
<i>FJALIME & PJESËMARRJE NË SEANCË</i>	20
<i>ANGAZHIMI NË KOMISION</i>	20
<i>VOTIMI I AKTEVE NË SEANCË</i>	10
<i>ADRESIM PYETJE – INFORMACION</i>	10
<i>AKTIV NË AKTIVITETIN PUBLIK</i>	10
<i>PENALIZIME ADMINISTRATIVE</i>	-5 deri -10
<i>HETIME NDAJ DEPUTETIT</i>	-20
<i>HEQJE TË IMUNITETIT</i>	-20
<i>HEQJE MANDATI</i>	-50

Në total janë 100 pikë, por edhe duke bërë vlerësimin zbritës negativ, (përfshitim nga seancat ose komisionet – nga 5 në 10 pikë në varësi nga niveli i masës penalizuese, heqje imuniteti apo hetime zyrtare nga -20 pikë, si dhe heqje mandati -50 pikë).

6.1. KLASIFIKIMI I DEPUTETËVE SIPAS NIVELIT TË EFIKASITETIT

Tabela me të dhëna për secilin deputet, prezanton një kuotim bazuar në treguesit e matshëm të monitorimit, - vlerësimin për nismat ligjore dhe propozimet e ndryshme ligjore dhe politike, vlerësimi për angazhimet në mbledhje e debate në komisionet parlamentare dhe në seancat plenare, vlerësimi për ushtrimin e të drejtës së interpelancave dhe të kërkesave për informacion, si dhe vlerësimi për angazhimet në debatet politike dhe publike, përfshirë aktivitetet në drejtim të elektoratit të zonës zgjedhore. Renditja tregon se vetëm 14 deputetë kanë kuotë vlerësimi mbi 50% të pikëve, ndërkohë që 66 deputetë kanë vlerësim në më pak sesa një e treta e vlerësimit të përgjithshëm.

KLASIFIKIMI I DEPUTETËVE SIPAS NIVELIT TË EFIKASITETIT

(Shtator – Dhjetor 2021)

NR	RENDITJA FINALE	MAX 100	PARTIA	NR	RENDITJA FINALE	MAX 100	PARTIA
1	JORIDA TABAKU	70	PD	64	GRIDA DUMA	32	PD
2	ERION BRAÇE	63	PS	65	MERITA BAKIU	32	PD
3	ALBANA VOKSHI	57	PD	66	FLORENC SPAHO	32	PS
4	ARBI AGALLIU	56	PD	67	PRANVERA RESULAJ	32	PS
5	ERISA XHIXHO	55	LSI	68	LAVDRIM KRRASHI	31	PS
6	EDUARD SHALSI	55	PS	69	FLAMUR HOXHA	31	PD
7	TAULANT BALLA	54	PS	70	LULZIM BASHA	31	PD
8	BUJAR LESKAJ	53	PD	71	ZEF HILA	31	PD
9	ANTONETA DHIMA	53	PS	72	EDUARD NDRECA	31	PS
10	FERDINANT XHAFERAJ	53	PD	73	KRESHNIK ÇOLLAKU	31	PD
11	TRITAN SHEHU	52	PD	74	LUAN BAÇI	31	PD
12	EMILJA KOLIQUI	51	PD	75	TOMOR ALIZOTI	30	PD
13	PETRIT VASILI	50	LSI	76	DASANTILA TAHIRAJ	30	PS
14	SORINA KOTI	50	PD	77	BESION AJAZI	30	PS
15	DASHNOR SULA	49	PD	78	SHPRESA MARNOJ	30	PS
16	INA ZHUPA	49	PD	79	LEFTER GËSHTENJA	30	PD
17	PETRO KOÇI	49	PS	80	MIRELA PITUSHI	29	PS
18	ERVIN SALIANJI	48	PD	81	ILIRIAN PENDAVINJI	29	PS
19	HELIDON BUSHATI	47	PD	82	LINDITA METALIAJ	29	PD-PR
20	NASIP NAÇO	47	PS	83	ENSLEMVERA ZAKE	28	PS
21	LUÇIANO BOÇI	46	PD	84	ANDIA ULLIRI	28	PD
22	SAIMIR KORRESHI	46	PD	85	HATIXHE KONOMI	28	PS
23	ARBEN PËLLUMBI	46	PS	86	ERALDA BANO	27	PD
24	ERMONELA FELAJ	46	PS	87	BAFTJAR ZEQAJ	27	PS
25	BLERINA GJYLAMETI	45	PS	88	LINDITA BUXHELI	27	PS
26	KLOTILDA BUSHKA	44	PS	89	BLEDJON NALLBATI	27	PD
27	AGRON DUKA	44	PAA	90	SELADIN JAKUPLLARI	26	PD
28	ORJOLA PAMPURI	44	PD	91	LAERT DURAJ	26	PS
29	ETJEN XHAFAJ	44	PS	92	ALBAN XHELILI	26	PS
30	FATION VEIZAJ	43	PD	93	GERTA DURAKU	26	PS

31	KLODIANA SPAHIU	43	PS	94	DAMIAN GJIKNURI	25	PS
32	AGRON GJEKMARKAJ	43	PD	95	ILIR TOPI	25	PS
33	ALFRED RUSHAJ	43	PD	96	KLEVIS XHOXHI	24	PS
34	MIMI KODHELI	42	PS	97	FLAMUR NOKA	24	PD
35	EDMOND SPAHO	42	PD	98	SHPËTIM IDRIZI	24	PDIU
36	ETILDA GJONAJ	42	PS	99	KASËM MAHMUTAJ	24	PD
37	ENKELEJD ALIBEAJ	42	PD	100	TEUTA RAMAJ	24	PS
38	XHELAL MZIU	42	PD	101	MONIKA KRYEMADHI	23	LSI
39	XHEMAL QEFALIA	41	PS	102	TATIANA PIRO	23	PS
40	DASHAMIR SHEHI	41	LZHK	103	LUAN DUZHA	23	PS
41	FADIL NASUFI	40	PS	104	MESILA DODA	23	PD
42	ALQI BLLAKO	40	PS	105	RAMADAN LIKAJ	23	PD
43	FLUTURA AÇKA	40	PD	106	BUJAR ÇELA	22	PS
44	ANILA DENAJ	40	PS	107	BLENDI KLOSI	22	PS
45	ISMET BEQIRAJ	39	PS	108	ANDUEL TAHIRAJ	21	PS
46	BARDHYL KOLLÇAKU	39	PS	109	AURORA MARA	21	PS
47	LULJETA BOZO	38	PS	110	NUSTRET AVDULLA	21	PDIU
48	BELIND KËLLIÇI	37	PD	111	SAIMIR HASALLA	21	PS
49	OERD BYLYKBASHI	37	PD	112	GERTJAN DEDA	21	PSD
50	ILIR METAJ	37	PS	113	JURGIS ÇYRBJA	21	PS
51	FATMIR MEDIU	37	PR	114	BENET BECI	21	PS
52	TONI GOGU	36	PS	115	AGRON SHEHAJ	21	PD
53	VULLNET SINAJ	36	PS	116	ORNALDO RAKIPI	20	PS
54	VANGJEL DULE	36	PBDNJ	117	ELDA HOTI	20	PD
55	KASTRIOT PIROLI	35	PD	118	ILIR NDRAXHI	20	PS
56	ISUF ÇELAJ	35	PD	119	PAULIN STERKAJ	19	PS
57	DHURATA ÇUPI	34	PD	120	NIKO KURI	18	PS
58	DENIS DELIU	34	PS	121	MERI MARKIÇI	18	PSD
59	ZHENI GJERGJI	34	PD	122	GLEDIS ÇELIKU	17	PSD
60	ILDA DHORI	33	PD	123	RRAHMAN RRAJA	15	PS
61	GRETA BARDELI	33	PD	124	EDI PALOKA	13	PD
62	FATMIR XHAFAJ	33	PS	125	SALI BERISHA	10	PAV.
63	GAZMENT BARDHI	32	PD	126	AGRON ÇELA	4	LSI

Shënim: Deputetët Ervin Sallianji dhe Bujar Çela janë vlerësuar me -5 pikë për shkak të akteve të tyre (incidente në seancë dhe deklarata publike për diktatorin)

6.2. DEPUTETËT MË EFIKASË: TABAKU (PD) DHE BRAÇE (PS)

Në klasifikimin e përgjithshëm të deputetëve me treguesit më të lartë të efikasitetit në sesionin e fundit parlamentar rezulton se janë pothuajse të njëjtit deputetë të sesionit 2017-2019, - Brace nga PS dhe Tabaku e Vokshi nga PD. Jorida Tabaku ka më shumë angazhime në seancë plenare, duke bërë diferencën me pikë me deputetin Braçe, duke qenë dy deputetët më të kuotuar në sesion.

Pas Vokshit në vendin e tretë, vjen deputeti i ri Agalliu, i vetmi nga deputetët e rinj në krye të renditjes për nivelin e efikasitetit. Agalliu ishte aktiv në debatet në komisione dhe në seancat plenare, si dhe aktiv edhe në debatet publike nga pozita e deputetit. Erisa

Xhixho e LSI dhe Eduard Shalsi nga PS kanë të njëjtën kuotë vlerësimi, pavarësisht se Xhixho nuk drejton komision parlamentar. Ajo ishte iniciuese e një ligji në parlament, ndërkohë që ishte aktive në debatet në komisione dhe në seancat plenare. Në 10 deputetët më të kuotuar bëjnë pjesë Taulant Balla dhe Antoneta Dhima nga PS, secili me përvojë parlamentare dhe me rezultate të larta edhe në legjislaturën e kaluar, si dhe Bujar Leskaj dhe Ferdinand Xhaferaj nga PD, të dy politikanë me përvojë.

Në pjesën tjetër të listës më të kuotuar bëjnë pjesë deputetë me përvojë të gjatë parlamentare si Tritan Shehu, Petrit Vasili apo Dashnor Sula, si dhe dy prurjet e reja në parlament, Koliqi dhe Koti, njëra deputete e qarkut Shkodër dhe tjetra e qarkut Korçë. Në listë bën pjesë edhe deputeti Petro Koçi, shumë aktiv në debatet politike dhe parlamentare, si dhe me përvojë të gjatë parlamentare e politike.

Lista e deputetëve më të kuotuar nuk ka ndonjë rëndësi të madhe në përfaqësimin parlamentar dhe as nuk sjell surpriza, pasi ka deputetë që edhe më parë kanë pasur kuotë të lartë efikasiteti por nuk janë rikandiduar nga partitë e tyre në zgjedhjet e 25 prillit, ndërkohë që emrat më fundor të klasifikimit vijnë të kandidohen dhe të fitojë rregullisht duke qenë në krye të listave shumëemërore të partive kryesore politike.

Megjithatë lista e deputetëve më të kuotuar ka vlerë referimi dhe vlerësimi për ata deputetë që mandatin parlamentar e kanë kuptuar jo vetëm si privilegj, ndaj edhe përgjegjësi, pra edhe si shërbim ndaj qytetarëve dhe publikut. Ata kanë zgjedhur të jenë aktiv, duke marrë përgjegjësi, duke riskuar në një mjedis politik të polarizuar dhe duke tentuar të krijojnë profil politik pozitiv për veten e tyre.

Lajm tjetër i mirë është se me ndonjë përjashtim, të gjithë deputetët e vlerësuar me kuotat më të larta janë edhe deputetë që nuk janë përfshirë në skandale korruptive, nuk akuzohen nga media dhe as politika, nuk janë protagonistë të konflikteve dhe nuk e kanë përdorur suksesin e tyre për të krijuar pozita më komode në partitë e tyre politike.

EMRI DHE MBIEMRI	PARTIA	PIKË
JORIDA TABAKU	PD	70
ERION BRAÇE	PS	63
ALBANA VOKSHI	PD	57
ARBI AGALLIU	PD	56
ERISA XHIXHO	LSI	55
EDUARD SHALSI	PS	55
TAULANT BALLA	PS	54
BUJAR LESKAJ	PD	53
ANTONETA DHIMA	PS	53
FERDINANT XHAFERAJ	PD	53
TRITAN SHEHU	PD	52
EMILJA KOLIQI	PD	51
PETRIT VASILI	LSI	50
SORINA KOTI	PD	50
DASHNOR SULA	PD	49
INA ZHUPA	PD	49
PETRO KOÇI	PS	49

6.3. DEPUTETËT MË PAK EFIKASË 2021

Në listën e deputetëve më pak të kuotuar, pra edhe me treguesit më minimalë të angazhimit dhe të efikasitetit në sesionin e parë parlamentar të legjislaturës së re, bëjnë pjesë emra të njohur edhe më parë për renditje të fillë, kryesisht prurje nga biznesi dhe zona bastion, ku mandatet fitohen edhe përmes kontestimeve dhe akuzave të ndryshme. Pjesë e listës është edhe ish-kryeministri Berisha, i cili gjatë sesionit u angazhuar masivisht në aktivitet politik brenda PD, duke mos zqjedhur të jetë aktiv dhe as prezent në aktivitetet parlamentare.

Në listë bëjnë pjesë edhe politikanë të lartë karriere, si Paloka (PD), të cilët nuk kanë rekorde angazhimi në komisione dhe as në aktivitetin parlamentar, apo prurje të reja, përfshirë 3 deputetët e PSD dhe më të votuarin në listën shumëemërore të PS, (Rakipi), si dhe ndër më të votuarit në listën shumëemërore të PD në Tiranë, politikanin e njohur për suksesin në fushën e biznesit, Agron Shehaj.

6.4. VLERËSIMI? OPOZITA MË EFIKASE SESA MAZHORANCA?

Një nga gjetjet krahasuese në vlerësimin e nivelit të efikasitetit është fakti se deputetët e PD-së dhe të LSI-së kanë mesatarisht nivel më të lartë angazhimi në aktivitetin parlamentar, sesa deputetët e mazhorancës. Për deputetët e PD-së mesatarja e angazhimit është 36 pikë, për deputetët e LSI është 34 pikë, më pas vijnë deputetët e PS-së me 33 pikë. Vlerësimin më negativ e marrin deputetët e PSD-së, të cilët janë pothuajse dyfish më pak të kuotuar sesa deputetët e PD-së.

Fakti që opozita është më aktive nuk i dedikohet ndonjë strategjie të grupeve përbërëse të saj, përkundrazi, kriza në radhët e opozitës është reflektuar ndjeshëm edhe në strategjinë e dobët në angazhimin parlamentar. Suksesi i dedikohet kryesisht

EMRI DHE MBIEMRI	PARTIA	PIKË
AGRON ÇELA	LSI	5
SALI BERISHA	PD	10
EDI PALOKA	PD	13
RRAHMAN RRAJA	PS	15
GLEDIS ÇELIKU	PSD	17
MERI MARKIÇI	PSD	18
NIKO KURI	PS	18
PAULIN STERKAJ	PS	19
ILIR NDRAXHI	PS	20
ELDA HOTI	PD	20
ORNALDO RAKIPI	PS	20
AGRON SHEHAJ	PD	21
BENET BECI	PS	21
GERTJAN DEDA	PSD	21
JURGIS ÇYRBJA	PS	21
SAIMIR HASALLA	PS	21
NUSTRET AVDULLAI	PDIU	21
ANDUEL TAHIRAJ	PS	21
AURORA MARA	PS	21

përpyjekjeve të personalizuar të deputetëve për të lënë gjurmë parlamentare, pra për të qenë aktiv dhe për të pasur një bilanc pozitiv në raport me publikun, median dhe zgjedhësit. Kjo shpjegohet nga fakti se disa deputetë të zgjedhur kryesisht në zonat e periferisë kanë qenë shumë më aktiv, sesa deputetë me përvojë dhe rol qendror në zhvillimet politike në vend.

Referuar kategorive të tjera, rezulton se gratë deputete kanë nivel më të lartë efektiviteti, sesa deputetët meshkuj, me diferencë 3 pikë më shumë, ndërkohë që në krahasimin midis deputetëve të rinj dhe deputetëve të vjetër me përvojë në jetën parlamentare diferenca është më e ndjeshme, + 7 pikë më shumë në favor të përvojës.


DEPUTETËT	PIKË/MP
DEPUTETËT E PS-SË	33 PIKË
DEPUTETËT E LSI-SË	34 PIKË
DEPUTETËT E PD+ SË	36 PIKË
DEPUTETËT E PSD-SË	19 PIKË
DEPUTETËT E RINJ	31 PIKË
DEPUTETËT E VJETËR	38 PIKË
GRATË DEPUTETE	36 PIKË
DEPUTETËT MESHKUJ	33 PIKË

6.5. QARKU I SHKODRËS ME DEPUTETËT MË PAK EFEKTIVË

Në klasifikimin e deputetëve sipas qarqeve dhe rezultateve të tyre të angazhimit parlamentar gjatë periudhës shtator-dhjetor 2021, rezulton se qarku Shkodër vijon të ketë deputetët më pak përfaqësues dhe më pak cilësorë, - me 24 pikë mesatarisht për deputet, ndjekur nga Durrësi, Kukësi, Lezha dhe Berati. Ndërkohë qarku me nivelin më të lartë përfaqësues është Gjirokastra me 39 pikë, qark i cili 50% të deputetëve të vet i ka gjithashtu ministra.

Një analizë e deputetëve të qarkut Shkodër, si qarku me treguesit më negativë në rendjen e efikasitetit, na lejon të bëjmë diferencën midis deputetëve aktivë (deputetja Koliqi ka nivelin më të lartë me 51 pikë, ndjekur nga Helidon Bushati e Greta Bardeli me

DEPUTETËT MË EFEKTIVË (SIPAS QARQEVE)



nga 47 dhe 33 pikë, ndërkohë që në fundin e listës bëjnë pjesë deputetët e LSI dhe të PSD-së, me nga 5-18 pikë, kuotat më të ulta të përfaqësimit edhe në nivel kombëtar. Pavarësisht se PSD mori dy mandate dhe LSI vijon të ketë përfaqësim permanent në këtë qark, përfaqësimi i tyre parlamentar ka shënuar rënie edhe në raport me legjislaturën e kaluar, ndërkohë që asnjë nga deputetët e Shkodrës nuk ka pozita të larta drejtuese në Kuvend, në komisione dhe në krye të grupeve parlamentare.

6.6. DEPUTETËT ME MË SHUMË FJALIME?

Renditja e deputetëve me më shumë fjalime gjatë sesionit të fundit parlamentar tregon se disa prej tyre përbëjnë figurat më të rëndësishme parlamentare, përfshirë kryeministrin Rama, kryetarin e PD Basha, etj. Petrit Vasili (LSI) ka numrin më të madh të fjalimeve, 13 fjalime në 16 seanca, nga të cilat 2-3 seanca janë inauguruese dhe procedurale, pra pa mundësi për fjalime dhe debate normale parlamentare.

Jorida Tabaku (PD) dhe Taulant Balla (PS) kanë të njëjtin numër fjalimesh, 12, me dallimin se Balla ka folur së paku 6 herë në emër të grupit, ndaj 2 rasteve të Tabakut. Katër deputetë, përfshirë

socialisti Braçe dhe demokratët Basha, Sula e Agalliu kanë të regjistruar nga 10 fjalime, Antoneta Dhima (PS) ka 9 fjalime, ndërkohë që pesë deputetë të tjerë, përfshirë kryeministri Rama, kanë nga 8 fjalime. Disa prej këtyre deputetëve, përfshirë Rama e Basha, kanë mbajtur më shumë se një fjalim në të njëjtën seancë plenare, gjithsesi për efekt statistikor fjalimet e një dite janë përlogaritur në një fjalim të vetëm.

Nga lista e deputetëve më aktiv me fjalime janë 3 emra që përbëjnë risi, - prurjet e reja në parlament Arbi Agalliu, Saimir Korreshi dhe Sorina Koti, të tre deputetë të PD-së, si dhe fakti se vetëm 4 nga 14 deputetët me më shumë fjalime janë gra deputete. Në vijim të listës, nga 6 fjalime kanë ministrija Balluku, kryetarët e partive Shehi dhe Mediu, deputetët me përvojë Xhaferaj dhe Boçi, si dhe deputetët e rinj Denis Deliu (PS), Emilja Koliqi (PD), Etjen Xhafaj (PS), Fation Veizaj (PD). Disa prej tyre janë deputetë që në seanca plenare kanë lexuar relacionet e akteve në komisione, pra më shumë sesa fjalime kanë lexime relacionesh të përgatitura nga ekspertët, gjithsesi për efekt statistikor, ata citohen si deputetët me më shumë angazhime në debatet në seancat plenare.

NR	EMRI I DEPUTETIT/ES	FJALIME	PARTIA
1	PETRIT VASILI	LSI	13
2	JORIDA TABAKU	PD	12
3	TAULANT BALLA	PS	12
4	ARBI AGALLIU	PD	10
5	DASHNOR SULA	PD	10
6	ERION BRAÇE	PS	10
7	LULZIM BASHA	PD	10
8	TRITAN SHEHU	PD	10
9	ANTONETA DHIMA	PS	9
10	ARBEN AHMETAJ	PS	8
11	EDI RAMA	PS	8
12	OGERTA MANASTIRLIU	PS	8
13	SAIMIR KORRESHI	PD	8
14	SORINA KOTI	PD	8

Në seancën e 25 tetorit për diskutime lidhur me problemet e zgjedhësve pati diskutime të shumta: 20 deputetë nga Partia Socialiste, përfshirë 3 ministra, 14 deputetë nga Partia Demokratike, si dhe 2 deputetë nga LSI. Raste të tilla dhe rastet e diskutimeve në periudhën 60 minutëshe pas axhendës ditore të seancave, janë raste të mira për deputetët për të lënë gjurmë në debatet parlamentare, por edhe për të promovuar çështje që lidhen me zonën e tyre zgjedhore, me elektoratin dhe me identitetin e tyre politik.

6.7. FJALIMET NË EMËR TË GRUPIT, DEPUTETËT MË TË PROMOVUAR

Në praktikat parlamentare grupet zgjedhin gjithnjë disa deputetë, të cilët promovohen në komisione dhe sidomos në seanca plenare duke i caktuar relatorë apo për të mbajtur qëndrime politike në emër të grupit. Secila parti ka listën e vet të preferuar. Deputetët që diskutojnë në emër të grupit nuk janë gjithnjë drejtuesit politikë të grupit parlamentar. Në monitorimet e mëparshme ka ndodhur që ndaj raporteve monitoruese të ISP të kenë reaguar disa deputetë, të cilët nuk figuronin në vendet kryesore të klasifikimit për shkak se drejtuesit e grupeve nuk i preferonin ata për promovim, duke i detyruar të heqin dorë nga fjalimet në seanca, ose duke i mënjanuar nga diskutime politike në emër të grupit.

Referuar të dhënave, edhe në sesionin e fundit parlamentar disa deputetë janë promovuar në fjalime duke folur në emër të grupit parlamentar, pra me përzgjedhje politike nga drejtuesit e grupeve. Konkretisht, Taulant Balla (PS) mban rekordin me 6 fjalime në emër të grupit, Sorina Koti (PD) mban rekordin në krahun tjetër politik me 4 fjalime në emër të grupit. Më tej, nga 3 fjalime në emër të grupit parlamentar kanë tre deputetët e PS-së, Anila Denaj, Blerina Gjylameti dhe Klotilda Bushka, ndërkohë që nga 2 fjalime në emër të grupit kanë deputetët e PD-së Alfred Rushaj, Albana Vokshi, Jorida Tabaku dhe Oerd Bylykbashi. Nga PDIU Mesila Doda ka 2 fjalime në emër të grupit nga 2 fjalime gjithsej që ka mbajtur në këtë sesion parlamentar.

6.8. 18 DEPUTETËT ME “0” FJALIME NË PARLAMENT

Në listën e deputetëve që nuk mbajtën asnjë fjalim në seancat plenare të sesionit shtator-dhjetor 2021 bëjnë pjesë 18 deputetë, nga të cilët, disa janë figura të njohura politike. Emrat më të njohur janë Berisha (Pav), Kodheli, Klosi dhe Gjikhuri (PS), por edhe prurje të reja si Beci (PS), Bllako (PS), Rakipi (PS), etj. Në listë bëjnë pjesë edhe “të përhershmit” Çela (LSI), Rraja, Duzha, Ndraxhi e Sterkaj (PS), por edhe 2 deputetët e rinj të PSD-së. Këta të fundit kanë votuar rregullisht pro mazhorancës, pa qenë pjesë zyrtare e saj, megjithatë nuk kanë pasur aktivitet as në komisione dhe as në seancat plenare.

Duke analizuar listën e deputetëve që nuk kanë gjurmë në debatet parlamentare, përveç rasteve specifike që lidhen me zhvillime jashtë parlamentit (Berisha dhe nisma e tij me Foltoren), mbetet domethënëse fakti se disa prurje nga biznesi, pa përvojë dhe mendim politik, vijojnë të jenë gjithnjë në pjesën më inaktive në jetën politike dhe në parlament. Kjo vlen edhe për prurjet e reja pa përvojë politike, por janë aty për shkak të kalkulimeve dhe lobimeve të ndryshme lokale.

Çështja është, kur disa deputetë nuk marrin pjesë në debatet parlamentare, nuk marrin pjesë ose nuk janë aktiv në komisione, nuk iniciojnë ligje dhe as ushtrojnë kompetencat e tjera parlamentare, atëherë përse kanë dashur të jenë deputetë, përse kanë kandiduar dhe çfarë përfaqësojnë në politikë. ISP ka opinionet dhe shpjegimet e tij, gjithsesi është zgjedhja e elektoratit dhe publikut për të pasur një vlerësim të tyre alternativ dhe më të qartë.

NR	EMRI I DEPUTETIT/ES	FJALIME	PARTIA
1	AGRON ÇELA	LSI	0
2	ALQI BLLAKO	PS	0
3	BENET BECI	PS	0
4	BLENDI KLOSI	PS	0
5	DAMIAN GJIKNURI	PS	0
6	GERTJAN DEDA	PSD	0
7	GLEDIS ÇELIKU	PSD	0
8	ILIR NDRAXHI	PS	0
9	ILIR TOPI	PS	0
10	JURGIS ÇYRBJA	PS	0
11	LUAN DUZHA	PS	0
12	MERI MARKIÇI	PSD	0
13	MIMI KODHELI	PS	0
14	ORNALDO RAKIPI	PS	0
15	PAULIN STERKAJ	PS	0
16	RRAHMAN RRAJA	PS	0
17	SALI BERISHA	PAV	0
18	TEUTA RAMAJ	PS	0

6.9. RAMA E BASHA: 11,5 ORË DISKUTIME DHE REPLIKA NË PARLAMENT

E drejta në Rregullore që fjala e kryeministrit dhe e drejtuesit të opozitës të jetë në të njëjtin minutazh kohor, është paraparë për të siguruar përfaqësim politik gjatë debateve parlamentare. Të dhënat monitoruese treguan se kryeministri Rama dhe kryetari i PD Basha diskutuan përkatësisht, 6.1 dhe 5.3 orë. Seanca e diskutimeve rekord, kryesisht si replika midis Ramës e Bashës u shënua në debatin për buxhetin më 15-16 nëntor 2021. Në këtë seancë kryeministri Rama diskutoi në total 136 minuta ose më shumë se dy orë, Basha 112 minuta, vetëm 8 minuta më pak sesa dy orë. Diskutime të tilla të gjata, të dominuara nga retorika ditore politike dhe të transmetuara live në të gjitha mediat informative, në vend të transparencës dhe efektivitetit parlamentar sjellin lodhje të publikut, bezdisje nga politika pa ide dhe dobësim edhe të rolit dhe pozitës kushtetuese të Kuvendit.

Në aspektin statistikor më 16 shtator Rama diskutoi 96 minuta (programi i qeverisë) dhe Basha 50 minuta, shifra e dytë më e lartë e diskutimeve të gjata të tyre. Seanca e tretë rekord u shënua me 28 tetor, seancë në të cilën Rama diskutoi 55 minuta dhe Basha 59 minuta, së bashku rreth dy orë, kuotë shumë më e lartë. Seanca e datës 20 dhjetor ishte më normalja në diskutimet e kryeministrit dhe kryetarit të opozitës, përkatësisht 12 dhe 11 minuta, kohë e mjaftueshme për të ofruar teza politike dhe për t'i dhënë edhe kuptim e solemnitë fjalimeve politike të liderit politik.

7. RAPORT PARAPRAK I MONITORIMIT TË MARRËDHËNIES SË INSTITUCIONEVE KRYESORE KUSHTETUESE DHE TË PAVARURA ME KUVENDIN

Në shtator të vitit 2021 nisi sesioni i ri parlamentar i periudhës 2021-2025. Në ndryshim nga përbërja e sesionit të kaluar, këtë sesion më shumë se gjysma e deputetëve janë zgjedhur për herë të parë. Ndërkaq, ajo që nuk ndryshon është roli thelbësor i Kuvendit në vendimmarrjen politike. Kjo pasi është pikërisht Kuvendi institucioni që mëshiron pushtetin legjislativ në Republikën e Shqipërisë.

Përpos sa më sipër, Kuvendi ushtron edhe funksione të tjera shumë të rëndësishme nga pikëpamja kushtetuese. Një ndër këto funksione dhe detyra është kontrolli i institucioneve kryesore kushtetuese dhe të pavarura të ngritura me ligj. Monitorimi i Kuvendit dhe i veprimtarisë parlamentare në raport me këto institucione, nevojat e këtyre të fundit dhe rezultatet e arritura prej tyre përgjatë çdo viti, është një kontribut për forcimin e shtetit ligjor dhe për një demokraci funksionale.

Për të evidentuar më së miri këtë marrëdhënie mes Kuvendit dhe institucioneve, bazuar në nenin 103 të Rregullores së Kuvendit, të ndryshuar, organet kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj, kanë detyrimin e raportimit vjetor pranë Kuvendit. Kjo realizohet përmes depozitimit të raportit në Kuvend nga institucionet dhe organizimit të seancës dëgjimore në komisionin përgjegjës për shqyrtim.

Ndërkaq, pikat 7 dhe 8 të po këtij neni parashikojnë ndër të tjera se, në seancë plenare raporti mbahet nga titullari i institucionit për jo më shumë se 20 minuta, lexohet projekt-rezoluta e komisionit përkatës për vlerësimin e punës së institucionit dhe vijohet me pyetjet dhe përgjigjet e tyre, si dhe hapjen nga drejtuesi i seancës të debatit, në rast se zhvillimi i debatit kërkohet me shkrim nga një komision i përhershëm, një kryetar grupi parlamentar, ose të paktën 10 deputetë.

Ky detyrim i Rregullores së Kuvendit është caktuar edhe si masë konkrete që duhet zbatuar në vijim nga Kuvendi, si pjesë e detyrave të vendosura edhe në *"Manualin për raportimin vjetor dhe periodik të institucioneve të pavarura"*, të miratuar me Vendimin nr.134/2018 të Kuvendit të Shqipërisë.

Vlen të theksohet se gjatë diskutimeve, shqyrtohen raportet e institucioneve që kanë detyrimin të raportojnë, diskutohet mbi këto raporte, kërkesat dhe nevojat e institucioneve, analizohet nëse janë përmbushur nga institucioni rekomandimet e

dhëna përmes Rezolutës së vitit paraardhës të Kuvendit, si dhe diskutohet mbi projektrezolutën e çdo komisioni përkatës.

Në fund të këtij procesi, Kuvendi miraton një rezolutë për çdo institucion të tillë, duke caktuar rekomandime konkrete për vitin pasardhës, në ato fusha që mendohet se është e nevojshme.

Sikurse e përmendëm edhe më sipër, një proces i tillë ndodh çdo vit dhe periudha e raportimit për vitin 2022 po afron sërish. Sjellim në vëmendje se raportimet do të depozitohen nga institucionet përgjatë muajve janar-maj. Në këto kushte, është objektivisht e vështirë për të kuptuar që tani përmbushjen e Rezolutës së Kuvendit nga këto institucione për vitin 2021. Megjithatë, pavarësisht sa më sipër, për tu njohur paraprakisht me ecurinë e zbatimit të Rezolutave të Kuvendit për secilin institucion, si dhe për të marrë një informacion më të detajuar në këtë drejtim, në zbatim të ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Instituti i Studimeve Politike (ISP) i është drejtuar më datën 21.12.2021 me një kërkesë për informacion këtyre institucioneve kushtetuese dhe të pavarura të krijuara me ligj.

Më konkretisht, ISP ka kërkuar informacion nga 24 institucione, për sa vijon:

- a) Cilat pika të Rezolutës së Kuvendit janë përmbushur nga institucionet gjatë vitit 2021;
- b) Nëse ka patur pika të papërmbushura nga institucionet nga Rezoluta e Kuvendit për vitin 2021, cilat kanë qenë arsyet e mospërmbushjes; si dhe
- c) Nëse kanë patur institucionet raste dhe/ose kërkesa të cilat ja kanë adresuar Kuvendit dhe sa janë marrë ato parasysh.

Vlen të theksohet se 18 institucione i janë përgjigjur kërkesës së ISP, e më konkretisht, institucionet e mëposhtme:

1. Agjencia e Sigurimit të Depozitave;
2. Autoriteti i Mediave Audiovizive;
3. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;
4. Autoriteti i Konkurrencës;
5. Avokati i Popullit;
6. Banka e Shqipërisë;
7. Enti Rregullator i Energjisë;
8. Enti Rregullator i Ujrave;
9. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave;
10. Këshilli i Lartë Gjyqësor;
11. Këshilli i Lartë i Prokurorisë;
12. Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil;
13. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
14. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
15. Komisioni i Prokurimit Publik;
16. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;
17. Këshilli Drejtues i Radio Televizionit Shqiptar;
18. Kontrolli i Lartë i Shtetit.


Ndërkaq, rezulton se 6 institucione nuk kanë kthyer përgjigje. Më konkretisht, këto institucione janë: Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare; Autoriteti për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit; Inspektori i Lartë i Drejtësisë; Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit; si dhe Prokurori i Përgjithshëm dhe Instituti i Statistikave.

Gjetjet

- **Nga përgjigjet e marra nga institucionet është konstatuar se 33% e tyre i kanë përmbushur plotësisht rekomandimet e dhëna nga Kuvendi përmes Rezolutës së vitit të shkuar, ndërsa 17% e tyre i kanë përmbushur pothuajse plotësisht. Ndërkaq, pothuajse 30% e tyre shprehen se i kanë përmbushur pjesërisht rekomandimet e Rezolutës së vitit të shkuar nga Kuvendi.**
- **Sa i përket pjesës tjetër, pra rreth 20% e tyre, shprehen se informacionin e kërkuar do t'ia paraqesin Kuvendit në momentin e duhur të raportimit, kërkojnë më shumë kohë, ose janë në proces analizimi të përmbushjes së Rezolutës.**

Përgjigjet e mësipërme janë paraqitur grafikisht në figurën 1 më poshtë:

Përgjigjet e institucioneve lidhur me përmbushjen e Rezolutës



Lidhur me sa më sipër, vlen të theksohet gjithashtu, se 6 institucione ende nuk janë përgjigjur.

Nga ana tjetër, është konstatuar se arsyet e mospërmbushjes së rekomandimeve nga ana e institucioneve janë gjithashtu për arsye të ndryshme. Më konkretisht, ato lidhen me situatën e pandemisë botërore Covid-19 dhe pasojat që shkaktoi ajo në Shqipëri, me faktorë që lidhen me subjekte të tretë, apo edhe me shkaqe të tjera përtej kontrollit apo ndikimit të institucionit.

Sa i përket kërkesave drejtuar Kuvendit gjatë vitit të shkuar, apo në vijim, si dhe marrjes së tyre në konsideratë nga Kuvendi, vlen të theksohet se nga përgjigjet e marra, ka rezultuar se vetëm 2 institucione i kanë drejtuar kërkesa Kuvendit. Më konkretisht,

Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar Kuvendit miratimin e buxhetit në përputhje me ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, kërkesë e shqyrtuar dhe e miratuar pjesërisht nga Kuvendi.

Ndërkaq, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kërkuar mbështetje financiare për investime në sisteme bashkëkohore të teknologjisë së informacionit, veçanërisht për zhvillimin e një Sistemi të ri të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore. Kërkesë kjo, e cila për shkak të vlerës mjaft të lartë e për pasojë të pa përballeshme nga buxheti i shtetit, nuk është marrë në konsideratë nga Kuvendi.

Konkluzione paraprake

- ❖ Sikurse e theksuam edhe më sipër, informacioni paraprak i marrë nga institucionet që po monitorohen është i pamjaftueshëm për të konkluduar me rezultate të sakta lidhur me nivelin e realizimit të rekomandimeve të Rezolutave të vitit të shkuar nga Kuvendi. Kjo pasi rreth 40% e tyre, ose 10 institucione nga 24 prej të cilave është kërkuar informacion, ende nuk kanë dhënë informacion të mjaftueshëm apo nuk janë përgjigjur për sa i është kërkuar.
- ❖ Deri në këto momente është konstatuar fakti se, referuar përgjigjeve të dhëna, në tërësi evidentohet një nivel nën mesatar i përmbushjes së rekomandimeve. Kjo pasi vetëm 33% institucioneve kanë rezultuar me një përmbushje të plotë të rekomandimeve, ndërsa 17% e tyre rezulton se kanë një përmbushje pothuajse të plotë.
- ❖ Nga ana tjetër, nga informacionet e mbledhura rezulton se kërkesat e këtyre institucioneve drejtuar Kuvendit lidhen kryesisht me aspekte financiare. Edhe në këtë pikë, rezulton se kërkesat nuk janë pranuar nga Kuvendi, ose janë pranuar pjesërisht.
- ❖ Për sa më sipër, për të kuptuar më mirë dhe më nga afër problematikat të cilat kanë çuar në mospërmbushjen e rekomandimeve nga institucionet, apo nëse këto arsye lidhen drejtpërdrejtë me kërkesa të papranuara të institucioneve nga Kuvendi, do të duhet të presim raportet e detajuara të të gjitha institucioneve pasi të jenë depozituar në Kuvend. Vetëm atëherë do të kemi mundësinë të konstatojmë më qartësisht situatën dhe të japim një analizë të drejtë të funksionimit të institucioneve dhe marrëdhënies së këtyre të fundit me Kuvendin.

8. ANEKS ME TË DHËNA TË DETAJUARA

TABELA ME RENDITJEN E DEPUTETËVE MBI BAZËN E KRITEREVE TË VLERËSIMIT

TË DHËNAT E DETAJUARA SIPAS KRITEREVE TË VLERËSIMIT TË EFIKASITETIT TË DEPUTETËVE

NR	EMRI DHE MBIEMRI	NISME LIGJORE	PROP O-ZIME	PR+DISK KOMISION	DISK SEANCË	KERKESË INFORMIM	INTER-PELANCE	VOTIM I LIGJEVE %	ZONË / PUBLIK	VLERESIM NEGATIV	TO-TALI
1	AGRON ÇELA	0	0	1	0	0	0	1	3	0	5
2	AGRON DUKA	10	6	9	3	0	0	6	10	0	44
3	AGRON GJEKMARKAJ	0	5	15	6	2	0	5	10	0	43
4	AGRON SHEHAJ	0	3	2	1	0	0	4	10	0	21
5	ALBAN XHELILI	0	2	8	3	0	0	10	3	0	26
6	ALBANA VOKSHI	0	6	20	7	10	0	4	10	0	57
7	ALFRED RUSHAJ	0	9	11	7	0	0	6	10	0	43
8	ALQI BLLAKO	0	5	20	0	0	0	10	5	0	40
9	ANDIA ULLIRI	0	1	8	4	0	0	7	7	0	28
10	ANDUEL TAHIRAJ	0	1	6	1	0	0	10	3	0	21
11	ANILA DENAJ	0	5	9	6	0	0	10	10	0	40
12	ANTONETA DHIMA	0	4	12	13	6	0	10	8	0	53
13	ARBEN PËLLUMBI	0	6	20	3	0	0	10	7	0	46
14	ARBI AGALLIU	0	8	15	14	0	0	9	10	0	56
15	AURORA MARA	0	1	6	1	0	0	10	3	0	21
16	BAFTJAR ZEQAJ	0	1	10	3	0	0	10	3	0	27
17	BARDHYL KOLLÇAKU	0	3	12	6	0	0	10	8	0	39
18	BELIND KËLLIÇI	0	4	12	6	0	0	6	10	0	37
19	BENET BECI	0	2	5	0	0	0	9	5	0	21
20	BESION AJAZI	0	1	11	3	0	0	10	5	0	30
21	BLEDJON NALLBATI	0	3	9	6	0	0	4	5	0	27
22	BLENDI KLOSI	0	1	9	0	0	0	8	4	0	22
23	BLERINA GJYLAMETI	0	5	15	7	0	0	10	8	0	45
24	BUJAR ÇELA	0	1	10	3	0	0	10	3	-5	22
25	BUJAR LESKAJ	0	10	12	7	6	0	8	10	0	53
26	DAMIAN GJIKNURI	0	2	3	0	0	0	10	10	0	25
27	DASANTILA TAHIRAJ	0	2	11	4	0	0	10	3	0	30
28	DASHAMIR SHEHI	0	6	11	9	0	0	6	10	0	41
29	DASHNOR SULA	0	5	13	14	0	0	9	8	0	49
30	DENIS DELIU	0	2	10	9	0	0	10	3	0	34
31	DHURATA ÇUPI	0	3	12	3	0	0	6	10	0	34

DEPUTETËT, KUVENDI DHE AKTIVITETI PARLAMENTAR
SHTATOR – DHJETOR 2021

32	EDI PALOKA	0	1	0	1	0	0	3	7	0	13
33	EDMOND SPAHO	0	8	15	6	0	0	7	7	0	42
34	EDUARD NDRECA	0	2	13	3	0	0	10	3	0	31
35	EDUARD SHALSI	0	8	20	7	0	0	10	10	0	55
36	ELDA HOTI	0	1	7	3	0	0	4	5	0	20
37	EMILJA KOLIQUI	0	10	15	9	0	0	8	10	0	51
38	ENKELEJD ALIBEAJ	0	10	12	4	0	0	6	10	0	42
39	ENSLEMVERA ZAKE	0	3	8	4	0	0	10	3	0	28
40	ERALDA BANO	0	1	11	4	0	0	6	5	0	27
41	ERION BRAÇE	0	10	15	14	6	0	8	10	0	63
42	ERISA XHIXHO	5	7	7	10	0	10	7	10	0	55
43	ERMONELA FELAJ	0	5	14	7	0	0	10	10	0	46
44	ERVIN SALIANJI	0	5	15	6	10	0	7	10	-5	48
45	ETILDA GJONAJ	0	3	18	3	0	0	10	8	0	42
46	ETJEN XHAFAJ	0	2	15	9	0	0	10	8	0	44
47	FADIL NASUFI	0	2	13	7	0	0	10	8	0	40
48	FATION VEIZAJ	0	6	14	9	0	0	5	10	0	43
49	FATMIR MEDIU	0	3	13	9	0	0	4	8	0	37
50	FATMIR XHAFAJ	0	3	8	3	0	0	9	10	0	33
51	FERDINANT XHAFERAJ	0	3	15	9	0	10	7	9	0	53
52	FLAMUR HOXHA	0	3	6	6	0	0	6	10	0	31
53	FLAMUR NOKA	0	1	6	1	0	0	5	10	0	24
54	FLORENC SPAHO	0	1	12	4	0	0	10	5	0	32
55	FLUTURA AÇKA	0	3	14	6	0	0	7	10	0	40
56	GAZMENT BARDHI	0	3	8	6	2	0	4	10	0	32
57	GERTA DURAKU	0	1	9	3	0	0	10	3	0	26
58	GERTJAN DEDA	0	1	8	0	0	0	10	2	0	21
59	GLEDIS ÇELIKU	0	1	4	0	0	0	10	2	0	17
60	GRETA BARDELI	0	2	9	6	0	0	6	10	0	33
61	GRIDA DUMA	0	3	9	7	0	0	3	10	0	32
62	HATIXHE KONOMI	0	1	11	1	0	0	10	4	0	28
63	HELIDON BUSHATI	0	4	13	7	10	0	3	10	0	47
64	ILDA DHORI	0	2	12	6	0	0	6	7	0	33
65	ILIR METAJ	0	2	12	3	0	0	10	10	0	37
66	ILIR NDRAXHI	0	1	6	0	0	0	10	3	0	20
67	ILIR TOPI	0	1	11	0	0	0	10	3	0	25
68	ILIRIAN PENDAVINJI	0	2	6	4	0	0	9	8	0	29
69	INA ZHUPA	0	5	17	10	0	0	7	10	0	49
70	ISMET BEQIRAJ	5	3	10	3	0	0	10	8	0	39
71	ISUF ÇELAJ	0	2	9	7	0	0	9	7	0	35
72	JORIDA TABAKU	0	10	18	17	10	0	5	10	0	70
73	JURGIS ÇYRBJA	0	1	5	0	0	0	10	5	0	21
74	KASËM MAHMUTAJ	0	1	9	1	0	0	6	6	0	24
75	KASTRIOT PIROLI	0	3	10	6	0	1	9	7	0	35
76	KLEVIS XHOXHI	0	1	8	1	0	0	10	4	0	24
77	KLODIANA SPAHIU	0	1	20	7	0	0	10	5	0	43
78	KLOTILDA BUSHKA	0	7	10	7	0	0	10	10	0	44
79	KRESHNIK ÇOLLAKU	0	1	12	6	0	0	4	8	0	31
80	LAERT DURAJ	0	1	10	1	0	0	10	4	0	26

DEPUTETËT, KUVENDI DHE AKTIVITETI PARLAMENTAR
SHTATOR – DHJETOR 2021

81	LAVDRIM KRRASHI	0	2	10	3	0	0	9	7	0	31
82	LEFTER GËSHTENJA	0	1	8	10	0	0	5	6	0	30
83	LINDITA BUXHELI	0	1	9	3	0	0	10	4	0	27
84	LINDITA METALIAJ	0	1	12	4	0	0	6	5	0	29
85	LUAN BAÇI	0	2	7	7	0	0	4	10	0	31
86	LUAN DUZHA	0	1	10	0	0	0	10	2	0	23
87	LUÇIANO BOÇI	0	7	15	9	0	0	5	10	0	46
88	LULJETA BOZO	0	3	12	3	0	0	10	10	0	38
89	LULZIM BASHA	0	5	0	14	0	0	2	10	0	31
90	MERI MARKIÇI	0	1	6	0	0	0	9	2	0	18
91	MERITA BAKIU	0	3	10	3	0	0	9	7	0	32
92	MESILA DODA	0	2	2	3	0	0	6	10	0	23
93	MIMI KODHELI	0	5	18	0	0	0	9	10	0	42
94	MIRELA PITUSHI	0	1	10	4	0	0	10	4	0	29
95	MONIKA KRYEMADHI	0	2	0	6	0	0	6	10	0	23
96	NASIP NAÇO	0	5	19	4	0	0	10	8	0	47
97	NIKO KURI	0	1	4	1	0	0	9	3	0	18
98	NUSTRET AVDULLA	0	1	8	1	0	0	9	2	0	21
99	OERD BYLYKBASHI	0	8	12	6	0	0	2	10	0	37
100	ORJOLA PAMPURI	0	6	12	10	0	0	6	10	0	44
101	ORNALDO RAKIPI	0	0	8	0	0	0	10	2	0	20
102	PAULIN STERKAJ	0	0	6	0	0	0	10	3	0	19
103	PETRIT VASILI	0	7	12	15	0	0	6	10	0	50
104	PETRO KOÇI	0	5	18	6	0	0	10	10	0	49
105	PRANVERA RESULAJ	0	1	10	6	0	0	10	5	0	32
106	RAMADAN LIKAJ	0	3	5	4	0	0	3	8	0	23
107	RRAHMAN RRAJA	0	0	3	0	0	0	10	2	0	15
108	SAIMIR HASALLA	0	0	8	1	0	0	10	2	0	21
109	SAIMIR KORRESHI	0	6	10	11	0	0	9	10	0	46
110	SALI BERISHA	0	0	0	0	0	0	-	10	0	10
111	SELADIN JAKUPLARI	0	1	13	3	0	0	6	3	0	26
112	SORINA KOTI	0	6	13	11	0	0	9	10	0	50
113	SHPËTIM IDRIZI	0	2	6	1	0	0	7	8	0	24
114	SHPRESA MARNOJ	0	2	9	3	0	0	10	6	0	30
115	TATIANA PIRO	0	2	5	1	0	0	10	5	0	23
116	TAULANT BALLA	0	8	9	17	0	0	10	10	0	54
117	TEUTA RAMAJ	0	1	8	0	0	0	10	5	0	24
118	TOMOR ALIZOTI	0	4	10	3	0	0	4	10	0	30
119	TONI GOGU	0	3	11	3	0	0	9	10	0	36
120	TRITAN SHEHU	0	4	8	14	0	10	5	10	0	52
121	VANGJEL DULE	0	4	6	4	0	5	7	10	0	36
122	VULLNET SINAJ	0	4	9	4	0	0	8	10	0	36
123	XHELAL MZIU	0	4	14	7	0	0	7	10	0	42
124	XHEMAL QEFALIA	0	4	14	4	0	0	9	9	0	41
125	ZEF HILA	0	3	4	1	10	-	4	9	0	31
126	ZHENI GJERGJI	0	2	11	4	0	0	6	10	0	34

Shënim: Deputetët Ervin Saliçanji dhe Bujar Çela janë vlerësuar me -5 pikë për shkak të akteve të tyre (incidente në seancë dhe deklarata publike për diktatorin)

TABELA ME RENDITJEN E PLOTË ME NUMRIN E FJALIMEVE

Të dhënat e tabelës janë ndihmuese për të bërë transparent aktivitetin parlamentar në një nga aspektet publike të tij, aftësinë për fjalime dhe debate në seancat plenare. Tabela përmbledh të gjitha të dhënat për të gjithë deputetët, duke lënë jashtë listës vetëm kreun e Kuvendit, i cili për shkak të funksionit ka përgjegjësinë të mirëdrejtjohë seancën. Në tabelë janë përfshirë edhe ministrat që nuk janë deputetë (pjesa italiane).

NUMRI I FJALIMEVE TË DEPUTETËVE NË KUVEND 2021

NR	EMRI I DEPUTETIT/ES	PARTIA	FJALIME	NR	EMRI I DEPUTETIT/ES	PARTIA	FJALIME
1	Petrit Vasili	LSI	13	73	Ilirian Pendavinji	PS	3
2	Jorida Tabaku	PD	12	74	Lindita Metaliaj	PD	3
3	Taulant Balla	PS	12	75	Milva Ekonomi	PS	3
4	<i>Delina Brahimaj*</i>	<i>PS</i>	<i>11</i>	76	Mirela Pitushi	PS	3
5	Arbi Agalliu	PD	10	77	Nasip Naço	PS	3
6	Dashnor Sula	PD	10	78	Niko Peleshi	PS	3
7	Erion Braçe	PS	10	79	Ramadan Likaj	PD	3
8	Lulzim Basha	PD	10	80	Vangjel Dule	PBDNJ	3
9	Tritan Shehu	PD	10	81	Vullnet Sinaj	PS	3
10	Antoneta Dhima	PS	9	82	Xhemal Qefalia	PS	3
11	Arben Ahmetaj	PS	8	83	Zheni Gjergji	PD	3
12	Edi Rama	PS	8	84	<i>Elva Margariti*</i>	<i>PS</i>	<i>3</i>
13	Ogerta Manastirliu	PS	8	85	<i>Frida Krifca*</i>	<i>PS</i>	<i>3</i>
14	Saimir Korreshi	PD	8	86	Agron Duka	PAA	2
15	Sorina Kofi	PD	8	87	Alban Xhelili	PS	2
16	Elisa Spiropali	PS	7	88	Arben Pëllumbi	PS	2
17	Erisa Xhixho	LSI	7	89	Baftjar Zeqaj	PS	2
18	Ina Zhupa	PD	7	90	Besion Ajazi	PS	2
19	Lefter Gështenja	PD	7	91	Bujar Çela	PS	2
20	Orjola Pampuri	PD	7	92	Dhurata Çupi	PD	2
21	Belinda Balluku	PS	6	93	Eduard Ndreca	PS	2
22	Dashamir Shehi	LZHK	6	94	Elda Hoti	PD	2
23	Denis Deliu	PS	6	95	Etilda Gjonaj	PS	2
24	Emilja Koliqi	PD	6	96	Fatmir Xhafaj	PS	2
25	Etjen Xhafaj	PS	6	97	Gerta Duraku	PS	2
26	Fation Veizaj	PD	6	98	Ilir Metaj	PS	2
27	Fatmir Mediu	PR	6	99	Ismet Beqiraj	PS	2
28	Ferdinant Xhaferaj	PD	6	100	Lavdrim Krrashi	PS	2
29	Luçiano Boçi	PD	6	101	Lindita Buxheli	PS	2
30	Albana Vokshi	PD	5	102	Luljeta Bozo	PS	2
31	Alfred Rushaj	PD	5	103	Merita Bakiu	PD	2
32	Bledar Çuçi	PS	5	104	Mesila Doda	PD	2
33	Blerina Gjylameti	PS	5	105	Mirela Kumbaro	PS	2
34	Bujar Leskaj	PD	5	106	Seladin Jakupllari	PD	2
35	Eduard Shalsi	PS	5	107	Shpresa Marnoj	PS	2
36	Ermonela Felaj	PS	5	108	Tomor Alizoti	PD	2
37	Fadil Nasufi	PS	5	109	Toni Gogu	PS	2
38	Grida Duma	PD	5	110	Agron Shehaj	PD	1
39	Helidon Bushati	PD	5	111	Anduel Tahiraj	PS	1
40	Isuf Çelaj	PD	5	112	Aurora Mara	PS	1
41	Klodiana Spahiu	PS	5	113	Edi Paloka	PD	1
42	Klotilda Bushka	PS	5	114	Edona Bilali	PS	1
43	Luan Baçi	PD	5	115	Flamur Noka	PD	1
44	Ulsi Manja	PS	5	116	Hatixhe Konomi	PS	1

DEPUTETËT, KUVENDI DHE AKTIVITETI PARLAMENTAR
SHTATOR – DHJETOR 2021

45	Xhelal Mziu	PD	5	117	Kasëm Mahmutaj	PD	1
46	Agron Gjekmarkaj	PD	4	118	Klevis Xhoxhi	PS	1
47	Anila Denaj	PS	4	119	Laert Duraj	PS	1
48	Bardhyl Kollçaku	PS	4	120	Niko Kuri	PS	1
49	Belinda Këlliçi	PD	4	121	Nustret Avdulla	PDIU	1
50	Bledjon Nallbati	PD	4	122	Saimir Hasalla	PS	1
51	Edmond Spaho	PD	4	123	Shpëtim Idrizi	PDIU	1
52	Ervin Salianji	PD	4	124	Tatiana Piro	PS	1
53	Evis Kushi	PS	4	125	Zef Hila	PD	1
54	Flamur Hoxha	PD	4	126	Agron Çela	LSI	0
55	Flutura Aça	PD	4	127	Alqi Bllako	PS	0
56	Gazment Bardhi	PD	4	128	Benet Beci	PS	0
57	Greta Bardeli	PD	4	129	Blendi Klosi	PS	0
58	Ilda Dhori	PD	4	130	Damian Gjikhuri	PS	0
59	Kastriot Piroli	PD	4	131	Gertjan Deda	PSD	0
60	Kreshnik Çollaku	PD	4	132	Gledis Çeliku	PSD	0
61	Monika Kryemadhi	LSI	4	133	Ilir Ndraxhi	PS	0
62	Oerd Bylykbashi	PD	4	134	Ilir Topi	PS	0
63	Olta Xhaçka	PS	4	135	Jurgis Çyrbja	PS	0
64	Petro Koçi	PS	4	136	Luan Duzha	PS	0
65	Pranvera Resulaj	PS	4	137	Meri Markiçi	PSD	0
66	<i>Bora Muzhaqi*</i>	<i>PS</i>	4	138	Mimi Kodheli	PS	0
67	Andia Ulliri	PLL	3	139	Ornaldo Rakipi	PS	0
68	Dasantila Tahiraj	PS	3	140	Paulin Sterkaj	PS	0
69	Enkelejd Alibeaj	PD	3	141	Rrahman Rraja	PS	0
70	Ensemvera Zake	PS	3	142	Sali Berisha	PAV	0
71	Eralda Bano	PD	3	143	Teuta Ramaj	PS	0
72	Florenc Spaho	PS	3	144	Lindita Nikolla	PS	-

Shënim: Në renditje nuk është përfshirë kryetarja e Kuvendit L.Nikolla, si dhe me italice () janë shënuar 4 ministret që nuk janë deputete*

MBI INSTITUTIN E STUDIMEVE POLITIKE

Instituti i Studimeve Politike (www.isp.com.al) është një organizatë e shoqërisë civile që vepron në fushën e demokratizimit dhe shtetit të së drejtës. Drejtor Ekzekutiv aktual është Prof. Afrim Krasniqi.

ISP është e fokusuar në monitorimin e institucioneve demokratike, si dhe në hartimin e raporteve / analizave profesionale mbi problematika specifike politike me interes për qytetarët, shoqërinë dhe partnerët ndërkombëtarë. Pjesë e ISP janë ekspertë të njohur të zhvillimeve politike dhe të drejtësisë, të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të marrëdhënieve publike. ISP publikon vazhdimisht raporte monitoruese.

DISA NGA PROJEKTET KRYESORE TE REALIZUARA VITET E FUNDIT NGA ISP:

- Database www.deputetim.al mbi monitorimin e Kuvendit të RSH (2017-vijon)
 - Database <http://dekriminalizimi.isp.com.al/> mbi integritetin në politikë (2017-vijon)
 - Database online www.muzeumemories.info Shqipëria në periudhën komuniste (2016-vijon)
 - Database www.politike.al mbi partitë politike, zgjedhjet, organizimin e tyre (2016-2019)
 - Monitorim të reformës në drejtësi (2016 - vijon)
 - Monitorimin e ligjit të dekriminalizimit dhe konfliktit të interesit në politikë (vijon)
 - Monitorimin e demokracisë së brendshme në partitë politike (2015-vijon)
 - Monitorimin e reformës zgjedhore (2017-vijon)
 - Monitorim i progresit të Shqipërisë drejt BE (2018-vijon)
 - Monitorim i zonave zgjedhore të riskut elektoral (2017 – vijon)
 - Monitorimi i përfaqësimit të grave në partitë politike (2015, 2017, 2019)
 - Monitorim i qeverisë me ministra teknikë dhe botim profesional me gjetjet (2018)
 - Monitorim të çështjeve që lidhen me emigracionin / diasporën (2018 - vijon)
 - Monitorimin e ligjit mbi të drejtën e informimit (2014-2018)
 - Monitorim i qeverisjes vendore (2016-2020)
- ❖ Raporti do t'u shpërndahet në rrugë elektronike dhe të printuar të gjithë deputetëve në parlament, partive politike parlamentare, partnerëve të ISP, ekspertëve të angazhuar, si dhe mediave kryesore.
- ❖ Të gjitha publikimet e ISP që lidhen me projekte kombëtare e ndërkombëtare (libra, studime, policy paper, raporte, etj) jepen falas për çdo të interesuar, si dhe publikohen në faqen zyrtare të ISP në formë të përmbledhur
- ❖ Për çdo interes, sugjerim apo informacion, mund të kontaktoni në çdo kohë ISP përmes adresës zyrtare, emailit, faqes së internetit, adresave të ISP në rrjetet sociale, etj.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Instituti i Studimeve Politike
Deputetët, Kuvendi dhe aktiviteti parlamentar në Shqipëri :
monitorim dhe analizë shtator-dhjetor 2021 / Instituti i
Studimeve Politike, drejt. projektin Afrim Krasniqi. – Tiranë : ISP, 2022...
f. ; ... cm.

ISBN 978-9928-4694-3-4

1.Parlamenti Shqiptar 2.Monitorime 3.Raporte 4.Shqipëri
328(496.5) "2021



Web: www.isp.com.al

Email: contactaips@isp.com.al dhe contactaips@gmail.com

Facebook: Instituti i Studimeve Politike / Institute for Political Studies

Adresa: Rr "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë

